# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

Kuvendi i Republikës së Kosovës;
Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 17, paragrafi 1 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr.04/L-037

Miraton :

## STATUTI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

### 1. Dispozitat e përgjithshme

**Neni 1**
**Themelimi**

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”(në tekstin e mëtejmë: “UP”) është themeluar në bazë të Ligjit mbi Themelimin e Universitetit të Prishtinës (“ Fletorja zyrtare e KSAK” nr. 33/69 më 18 nëntor 1969).

### Emri, selia, struktura dhe simbolet

**Neni 2**

Emri i Universitetit është Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

**Neni 3**

Selia e Universitetit është në Prishtinë.

**Neni 4**

Universiteti përbëhet nga njësitë akademike dhe njësitë organizative, siç parashihet në këtë Statut.

**Neni 5**

**1.** Universiteti ka këto simbole:
- **1.1.** Stemën,
- **1.2.** Vulën dhe vulën e thatë,
- **1.3.** Flamurin,

**1.4.** Gjerdanin e rektorit,
**1.5.** Pelerinën e rektorit, të prorektorëve dhe të dekanëve të njësive akademike.

**2.** Simbolet e Universitetit caktohen nga Këshilli drejtues sipas propozimit të Senatit.

**3.** Njësitë akademike të Universitetit kanë të drejtë të përdorin emrin, stemën dhe flamurin e Universitetit.

**4.** Data e përvjetorit të UP-së është data 15 shkurt (dita kur është mbajtur seanca e parë e Kuvendit të Universitetit në vitin 1970).

## Neni 6
## Misioni

**1.** Universiteti është institucion publik autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. Universiteti ka këto qëllime:

**1.1.** Të veprojë si qendër institucionale dhe udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
**1.2.** Të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
**1.3.** Të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
**1.4.** Të synojë të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
**1.5.** Të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase;
**1.6.** Të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
**1.7.** T'i përshtatet standardeve evropiane;
**1.8.** Të integrohet plotësisht në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore si dhe të ndërmarrë hapat adekuat reformues të nevojshëm për arritjen e këtij misioni.

## Neni 7

Universiteti obligohet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi ne baze gjinie, race, orientimi seksual, statusi martesor, gjuhe, religjioni, besimi politik a diç tjetër, përkatësi kombëtare, etnike ose sociale, përkatësia një komuniteti kombëtar, pasuria, statusi i lindjes apo ndonjë status tjetër.

## Neni 8

Universiteti siguron dhe mbështetë barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet dhe te arriturat profesionale te barabarta, përparësi do t'i jepet kandidates femër.

## Neni 9

Stafi akademik dhe administrativ i Universitetit dhe studentet duhet të sillen në përputhje me standardet më të larta të përkushtimit, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë, sinqeritetit, ndershmërisë dhe udhëheqjes.

**Neni 10**

Universiteti gëzon autonominë dhe lirinë e mësimdhënies akademike, të kërkimeve shkencore si dhe të krijimtarisë artistike brenda veprimtarisë së tij. Mjediset e Universitetit gëzojnë të drejtën e paprekshmërisë, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligje të veçanta.

**Neni 11**

Stafi akademik, administrativ dhe studentët e Universitetit gëzojnë te drejten e bashkimit dhe të shprehjes brenda strukturave të parapara me këtë Statut.

**Neni 12**
**Të drejtat dhe detyrat**

**1.** Universiteti ka këto të drejta dhe detyra :

**1.1.** Të zgjedhë autoritetet qeverisëse dhe menaxhuese dhe të përcaktojë mandatin e tyre;

**1.2.** Të rregullojë strukturat dhe aktivitetet e tij përmes rregullave të Universitetit bazuar në dispozitat e këtij Statuti, në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë dhe me akte të tjera nënligjore të nxjerra prej tij dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi;

**1.3.** Të zgjedhë personelin mësimor dhe personelin tjetër, të përcaktojë kushtet shtesë për pranimin e studentëve dhe metodat e mësimdhënies e të vlerësimit të studentëve, të miratuara nga AKA – ja;

**1.4.** Të hartojë dhe zbatojë në mënyrë të pavarur planprogramet, kërkimet shkencore dhe projektet artistike;

**1.5.** Të bëjë përzgjedhjen e fushave për studim;

**1.6.** Të japë tituj për profesorët dhe personelin tjetër, në pajtueshmëri me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, me ligjin në fuqi për punësim si dhe skemën e aprovuar nga AKA–ja.

**Neni 13**

**1.** Universiteti është person juridik dhe ka subjektivitet të plotë ligjor lidhur me të gjitha të drejtat dhe detyrat në lidhje me çështjet që trajtohen në ligjet e aplikueshme duke përfshirë:

**1.1.** Të drejtën për të paditur dhe të drejtën për t’u paditur;

**1.2.** Rregullimin e organizimit të vet të brendshëm;

**1.3.** Kufizimin e drejtës për përdorimin e titullit të universitetit vetëm për personat ose organizatat që e kanë autorizimin nga Këshilli drejtues i Universitetit;

**1.4.** Zotërimin dhe menaxhimin e trojeve dhe godinave dhe pasuri të tjera kapitale;

**1.5.** Pranimin dhe administrimin e fondeve nga çdo burim i ligjshëm;

**1.6.** Propozimin e taksave, tarifave dhe gjobave Ministrisë për miratim;

**1.7.** Për të emëruar dhe ndërprerë marrëdhënien e punës së personelit akademik dhe joakademik si dhe për të ushtruar të gjitha detyrat e një punëdhënësi, siç është paraparë me legjislacionin në fuqi;

**1.8.** Nënshkrimin e kontratave për mallra dhe shërbime dhe projekte kapitale;

**1.9.** Miratimin për përmbajtjen dhe strukturën e programeve të tij akademike shkencore, artistike dhe profesionale;
**1.10.** Krijimin e marrëdhënieve juridike me studentët dhe përshkrimin e kushteve për pranimin e tyre;
**1.11.** Vendosjen e metodologjive të zbatuara të mësimdhënies dhe mësim nxënies;
**1.12.** Aplikimin e masave të duhura për vlerësim dhe sigurim të cilësisë;
**1.13.** Dhënien dhe anulimin e titujve, diplomave, thirrjeve dhe gradave shkencore, dhe titujve nderi;
**1.14.** Themelimin e ndërmarrjeve komerciale, jokomerciale, instituteve për qëllime mësimore, shkencore-hulumtuese, shërbimeve profesionale dhe artistike;
**1.15.** Nënshkrimin e marrëveshjeve me bartësit vendorë dhe ndërkombëtar ;
**1.16.** Miratimin, përmbajtjen dhe formën e flamurit, të vulës dhe të emblemave të tjera dhe
**1.17.** Kompetenca të tjera të nevojshme për kryerjen e funksionit të tij sipas ligjit.

**Neni 14**

**1.** Njësitë akademike dhe njësitë organizative të Universitetit nuk janë persona juridik. Njësitë akademike dhe organizative të Universitetit kanë ato autorizime që parashihen me këtë Statut. Njësitë akademike dhe njësitë organizative të Universitetit janë programe të veçanta në kuadër të UP-së, gjegjësisht UP-ja është organizatë buxhetore në kuadër të Ligjit për buxhetin e përberë nga programet-njësitë akademike.
**2.** UP zhvillon aktivitetin e prokurimit për të gjitha njësitë akademike, njësitë akademike kanë buxhetin e planifikuar në kuadër të UP-së dhe kanë mundësinë e caktimit të prioriteteve nëpërmes të kërkesave për zotim-shpenzim.
**3.** Autoriteti menaxhues, të cilit i është dhëne autorizimi, ka për detyrë t'ia dorëzojë rektorit raportin vjetor të detajuar në lidhje me të gjitha aspektet e udhëheqjes relevante përfshirë:

**3.1.** Kontratat dhe marrëveshjet;
**3.2.** Shfrytëzimin e përgjithshëm të burimeve;
**3.3.** Llogarinë dhe rrjedhën e buxhetit;
**3.4.** Punësimin e personelit të veçantë;
**3.5.** Shfrytëzimin e pajisjeve dhe godinave;
**3.6.** Përmbushjen e objektivave të projektit.

**4.** Autoriteti menaxhues është përgjegjës që të dorëzojë raportin e tillë edhe për periudhën më të shkurtër, me kërkesë të rektorit.
**5.** Në rast të keqperdorimit te autorizimit Rektori ka të drejtë të pezullojë autorizimin derisa të marrë një vendim përfundimtar Këshilli drejtues i Universitetit.

**Neni 15**

Nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tej Ministria) po që se plotësohen kushtet e përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë të Kosovës, Universitetit i jepet e drejta për shfrytëzimin e tokës shoqërore dhe publike, ndërtesave dhe pajisjeve.

**Neni 16**
**Qeverisja e Universitetit**

**1.** Autoritetet kryesore qeverisëse të Universitetit janë Këshilli drejtues, Rektori dhe Senati.
**2.** Të gjitha autoritetet qeverisëse të Universitetit ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Statut.
**3.** Mandati i të gjithë zyrtarëve qeverisës dhe autoriteteve qeverisëse e anëtarëve të tij fillon me 1 tetor, nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Statut.

**Neni 17**
**Këshilli drejtues i Universitetit**

**1.** Këshilli drejtues i Universitetit (më tej 'Këshilli drejtues') është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit.
**2.** Këshilli drejtues ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të Universitetit.
**3.** Këshilli drejtues është përgjegjës për të gjitha vendimet në lidhje me çështjet financiare (buxheti, personeli, infrastruktura), në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të Universitetit në përputhje me obligimet e tij.
**4.** Këshilli drejtues, kolektivisht i raporton dhe është përgjegjës para Ministrisë së financave, për shfrytëzimin e duhur e në mënyrë efektive të fondeve që Ministria ose ndonjë burim tjetër publik ia ka ndarë Universitetit.
**5.** Këshilli drejtues mund të formojë komisione të përkohshme për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.
**6.** Këshilli drejtues formon Komisionin për çështje statutare si komision këshillëdhënës. Komisioni informon autoritetet e universitetit lidhur me të gjitha rastet e moszbatimit të Statutit dhe akteve tjera në çështjet e caktuara, nga autoritetet kompetente si dhe merr pjesë në hartimin ose jep mendimin në procedurën e përgatitjes së akteve dhe rregulloreve të nxjerra nga Universiteti. Këshilli drejtues me akt të veçantë rregullon çështjet lidhur me Komisionin për çështje statutare.

**Neni 18**

**1.** Këshilli drejtues përbëhet nga nëntë anëtarë me të drejtë vote.
**2.** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë emëron katër anëtarë me të drejtë vote dhe ata emërohen sipas dispozitave të Ligjit mbi Arsimin e Lartë. Ata duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste si dhe me aftësi të tjera praktike. Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet.
**3.** Senati zgjedh pesë anëtarë të Këshillit drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i Universitetit.
**4.** Anëtarët e Këshillit drejtues veprojne te pavarur dhe nuk perfaqesojne asnje interes tjeter individual apo grupor.
**5.** Anëtarë të Këshillit drejtues nuk mund te zgjedhen :

**5.1.** Rektori, prorektori, dekani, prodekani,
**5.2.** Anëtarët e Senatit,
**5.3.** Sekretari i përgjithshëm, sekretari i fakultetit.

**6.** Anëtari i Këshillit të fakultetit, që zgjidhet anëtar i Këshillit drejtues, duhet të heqë dorë nga anëtarësia në Këshillin e fakultetit.

**7.** Rektori, dhe sekretari i përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të Këshillit drejtues pa të drejtë vote.

**8.** Me ftesë të Këshillit drejtues në takime mund të marrin pjesë edhe prorektorët .

**9.** Kryetari i parlamentit të studentëve mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me studentët.

**Neni 19**

**1.** Këshilli drejtues çdo vit zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin prej anëtarëve të vet, të cilët nuk janë zyrtar të Universitetit.

**2.** Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat tri vjet me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat. Zgjedhjet për Këshillin drejtues mbahen në qershor kurse mandati i Këshillit drejtues fillon më 1 tetor.

**Neni 20**

**1.** Këshilli drejtues harton dhe miraton Rregulloren e vet te punës.

**2.** Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit drejtues nevojitet kuorumi prej gjashtë anëtarëve.

**3.** Vendimet në Këshillin Drejtues merren me shumicën e votave te anetareve prezent. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare.

**4.** Për vendimet e mëposhtme të Këshillit drejtues nevojitet shumica e kualifikuar e 2/3 të votave të anëtarëve:
**4.1.** Per zgjedhjen dhe shkarkimin e rektorit dhe prorektoreve;
**4.2.** Për planin vjetor financiar;
**4.3.** Per miratimin e rregullores se punes;

**5.** Këshilli drejtues miraton rregullore të veçanta për elaborimin e planit financiar vjetor.

**6.** Mbledhjet e Këshillit drejtues i thërret kryesuesi. Në raste të jashtëzakonshme mbledhjet thirren me 2/3 e anëtarëve të Këshillit drejtues. Rendi i ditës për takimet e Këshillit drejtues vendoset nga Kryesuesi respektivisht Zëvendës kryesuesi në bashkëpunim me rektorin.

**Neni 21**

**1.** Rektori ofron mbështetje të nevojshme teknike dhe infrastrukturore për Këshillin drejtues.

**2.** Me kërkesë të Këshillit, Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për sigurimin e informatave plotësuese për vendimet e marra nga Këshilli drejtues.

**Neni 22**

**1.** Në pajtim me dispozitat e këtij Statuti, Këshilli drejtues ka këto përgjegjësi:

**1.1.** Të zhvilloj një plan strategjik trevjeçar, i cili do të rishikohet çdo vit.

Në përgatitjen e planit strategjik dhe të aktualizimeve vjetore të tij, Këshilli drejtues do të konsultohet me Ministrinë përkitazi me përputhjen e objektivave dhe planeve të veta me Strategjinë shtetërore për arsimin e lartë dhe të burimeve që do të jenë në dispozicion nga Ministria. Fushëveprimi i konsultimeve të tilla përcaktohet me akt nënligjor që e nxjerr Ministria;

**1.2.** Të monitorojë shfrytëzimin e efektshëm dhe të frytshëm të burimeve, likuiditetin dhe sigurimin e aseteve të Universitetit në emër të publikut;

**1.3.** Të zhvillojë strategjitë për sigurimin adekuat të mjeteve nga burimet publike dhe private, duke marrë parasysh lehtësimet me rastin e krijimit të kompanive ndihmëse dhe instituteve për shfrytëzimin e rezultateve të punës akademike të Universitetit;

**1.4.** Të diskutojë dhe miratojë planin vjetor të buxhetit të përgatitur nga rektori dhe të dorëzojë këtë plan tek autoritetet përkatëse shtetërore;

**1.5.** Të definojë parimet mbi punësimin, delegimin, nivelizimin, promovimin, suspendimin, shkarkimin dhe përcaktimin e nivelit të pagave dhe të kushteve të punës për personel;

**1.6.** Të vendosë në lidhje me themelimin, shuarjen dhe ndryshimin e strukturës së brendshme të njësive akademike dhe njësive organizative pasi që të jetë miratuar nga Senati.

**Neni 23**

**1.** Detyrat e Këshillit drejtues janë:

**1.1.** Të sigurojë parakushte për administrim dhe menaxhim të drejtë të burimeve në nivel të Universitetit dhe njësive të tij vartëse;

**1.2.** Të nxjerrë rregullore për delegim të kompetencave për mjetet dhe çështjet e tjera administrative tek njësitë akademike të Universitetit në përputhje me dispozitat e këtij Statuti;

**1.3.** Të nxjerrë rregullore për qeverisjen, drejtimin dhe menaxhimin e Universitetit, siç kërkohet me këtë Statut;

**1.4.** Të vendosë për strukturën e përgjithshme organizative të njësive akademike, sipas propozimit të Senatit dhe pasi të jenë konsultuar njësitë në fjalë;

**1.5.** Të organizojë kontrollin financiar në pajtim me Ligjin dhe këtë Statut;

**1.6.** Të nxjerrë rregullore, në pajtim me këtë Statut, në lidhje me:

**1.6.1.** Masat dhe procedurën disiplinore për personelin akademik dhe studentët;

**1.6.2.** Pagesat dhe kushtet e shërbimit për personelin;

**1.6.3. P**rocedurat e mënyrave të kompensimit të personelit, në bazë të ankesave në lidhje me punësimin e tyre;

**1.6.4. S**uspendimin apo shkarkimin nga puna të personelit;

**1.6.5**. Ankesat kundër pezullimeve dhe shkarkimeve të tilla.

**1.7**. Ti propozoj Ministrisë tarifat e pagesave të shkollimit që duhet të paguajnë studentët e pranuar, dhe në disa raste të përcaktojë tarifat për shqyrtimin e aplikacioneve për regjistrim, për përsëritjen e provimeve dhe për diplomim dhe këto tarifa do të konfirmohen nga Ministria;

**1.8.** Të përcaktojë rregulla për llogaritjen e shpenzimeve për shërbimet universitare, që i ofrohen palëve të treta;

**1.9.** Të zgjedhë rektorin nga lista e emrave, të propozuar nga komisioni profesional prej pese (5) anetareve i emëruar nga Senati;
**1.10.** Të zgjedhë prorektorët sipas propozimit të rektorit;
**1.11**. Të përkujdeset që dispozitat e përgjithshme të këtij Statuti të zbatohen në praktikë brenda Universitetit;
**1.12.** Të veprojë sipas dispozitave të përgjithshme të përcaktuara në këtë Statut;
**1.13**. Të vendosë për formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës, vulës së thatë, flamurit dhe simboleve të tjera institucionale si dhe ti propozojë Ministrisë formën dhe përmbajtjen e diplomave sipas propozimit të Senatit.

**Neni 24**

**1.** Këshilli drejtues do të publikojë raportin vjetor mbi plotësimin e punës së Universitetit në përputhje me kërkesat e Ministrisë dhe të Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Raporti duhet të ofrojë informata lidhur me këto aspekte:

- **1.1.** Objektivat e përgjithshme strategjike të arritura;
- **1.2.** Të dhënat statistikore për tërë Universitetin dhe njësitë e tij akademike dhe organizative në lidhje me burimet:
  - **1.2.1.** Buxheti (fondet publike dhe private),
  - **1.2.2.** Personeli (shifrat zhvillimore);
  - **1.2.3.** Infrastruktura;
  - **1.2.4.** Profilin akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.);
  - **1.2.5.** Programet e studimit;
  - **1.2.6.** Numrin e studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit);
  - **1.2.7.** Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet);
  - **1.2.8.** Bashkëpunimin ndërkombëtar;

**2.** Raportin vjetor të auditorit për shfrytëzimin e duhur të mjeteve.
3. Ne pajtim me Ligjin per Arsimin e Larte, Keshilli drejtues i raporton Ministrise per realizimin e planit strategjik zhvillimor me se largu deri me 31 mars te vitit te ardhshem.
4. Raportet duhet te publikohen ne web faqen e Universitetit.

**Neni 25**
**Rektori**

**1.** Rektori është autoriteti kryesor menaxhues i Universitetit.
**2.** Rektori është përgjegjës për punën efektive dhe të rregullt të Universitetit dhe për menaxhimin e tij sipas politikës së përcaktuar nga Këshilli drejtues, dhe ka gjithë autoritetin e nevojshëm për ushtrimin e këtyre detyrave.
**3.** Detyrat e rektorit specifikohen në kontratën e punës.

**Neni 26**

**1.** Rektorin e zgjedh Këshilli drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga

Komisioni profesional prej pese (5) anetareve të cilin komision e formon Senati. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikoj nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.

**2.** Këshilli drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga Komsioni profesional duke arsyetuar atë.

**3.** Rektori zgjidhet me shumicën absolute (shumicën e anëtarëve të përgjithshëm) në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. Në rast se asnjë kandidat nuk fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Nëse asnjëri nga dy kandidatët nuk fiton shumicën absolute tri herë radhazi, procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, siç është paraparë në këtë Statut.

**4.** Emërimi i rektorit bëhet për një periudhë prej katër vitesh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

**5.** Mandati i rektorit fillon me një tetor.

**6.** Këshilli drejtues ne konsultim me Senatin nxjerr rregulloren për procedurën e zgjedhjes dhe mandatin e Rektorit.

## Neni 27

**1.** Për të udhëhequr procedurën e zgjedhjes së autoriteteve qeverisëse dhe menaxhuese të universitetit dhe dekanët, Senati zgjedh një kryesues të përkohshëm, anëtarë i Senatit nga radha e personelit akademik.

**2.** Pozita e rektorit shpallet nga Këshilli drejtues me konkurs publik në një afat prej pesëmbëdhjetë ditësh pasi të jetë konsultuar me rektorin.

**3.** Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur. për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm. Kandidati duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

**3.1.** Të ketë përvojë të dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkim shkencor dhe të ketë gradën e profesorit të rregullt, të profesorit të asocuar ose profesor asistent.

**3.2.** Të ketë përvojë të dëshmuara menaxhuese universitare.

**4.** Komisioni profesional i zgjedhur nga Senati propozon listën prej kandidatëve të zgjedhur me shumicë votash, për t'u zgjedhur nga Këshilli drejtues.

**5.** Këshilli drejtues i interviston kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në këto intervista secili kandidat prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të Universitetit dhe për qasjen e tij menaxhuese.

## Neni 28

**1.** Rektori ka këto përgjegjësi :

**1.1.** Të veprojë në emër të Universitetit dhe ta përfaqësojë atë para publikut të gjerë;

**1.2.** Të organizojë, drejtojë dhe menaxhojë Universitetin;

**1.3.** Të udhëheq personelin akademik;

**1.4.** Të vendosë për rregulloren e punës për personelin akademik të Universitetit në kuadër të kornizës së caktuar nga Këshilli drejtues;

**1.5.** Të punësojë, delegojë, nivelizojë, promovojë, suspendojë dhe të përcaktojë kushtet e punës për personel në pajtim me rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues dhe Senati;

**1.6.** Ta kryesojë Senatin;
**1.7.** Të paraqesë para Këshillit drejtues propozime në lidhje me karakterin arsimor dhe misionin e Universitetit duke marrë parasysh rekomandimet dhe mendimin e Senatit;
**1.8.** Të zbatojë vendimet e Këshillit drejtues;
**1.9.** Të menaxhojë buxhetin dhe mjetet në kuadër të shumës së miratuar nga Këshilli drejtues;
**1.10.** Të prezantoj raportin vjetor të buxhetit për të hyrat dhe shpenzimet për vlerësim nga Këshilli drejtues;
**1.11.** Të nënshkruajë kontrata në emër të Universitetit me palët e treta;
**1.12.** Të nënshkruajë diplomat dhe certifikatat e tjera zyrtare të Universitetit;
**1.13.** Të propozojë kandidatët për postin e prorektorëve, për t'u zgjedhur nga Këshilli Drejtues;
**1.14.** Të propozoj kandidatët për postin e sekretarit të përgjithshëm;
**1.15.** Të shpallë të gjithë titujt akademikë;
1.16. Rektori ka të drejtë të formojë komisione këshillëdhënëse;
**1.17.** Të kryejë të gjitha detyrat e tjera në emër të Universitetit, siç janë përcaktuar me këtë Statut apo me rregulloret e tjera në fuqi.

**Neni 29**

Rektori do ta njoftoj Këshillin drejtues për çdo veprim apo lëshim të Këshillit drejtues, i cili, sipas mendimit të rektorit, përbën një shpërdorim të fondeve publike që i janë dhënë. Në rast se Këshilli drejtues nuk vepron për të korrigjuar një veprim të tillë jo të duhur apo lëshim, atëherë Rektori do t'ia raportojë drejtpërdrejt këtë veprim ose lëshim Ministrisë. Në raste të tilla Këshilli drejtues nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim ndaj Rektorit, me përjashtim të rasteve kur vetë Ministria e lejon një gjë të tillë.

**Neni 30**

Autoriteti i Rektorit do të simbolizohet përmes gjerdanit të Rektorit.

**Neni 31**

**1.** Mandati i Rektorit mund të përfundojë para kohe në rast të:
**1.1.** Dorëheqjes;
**1.2.** Shkarkimit nga detyra;
**1.3.** Arsyeve shëndetësore;
**1.4.** Dënimit për vepër penale;
**1.5.** Pensionimit;
**1.6.** Vdekjes.
**2.** Procedurat për shkarkimin e rektorit mund të iniciohen me shumicën absolute të votave nga:
**2.1.** Këshilli drejtues;
**2.2.** Senati.
**3.** Procedura për shkarkimin e rektorit përcaktohet me rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues. Vendimi i Këshillit drejtues për shkarkim është valid me shumicën e kualifikuar të 2/3 të votave të anëtarëve.
**4.** Në rast të shkarkimit të rektorit përfundon edhe mandati i prorektorëve.

**5.** Në rast të shkarkimit, rektori dhe prorektorët e posa zgjedhur, do të zgjidhen për periudhën e mbetur të mandatit të rektorit të shkarkuar.
**6.** Në rastin e shkarkimit të rektorit, apo në çfarëdo rasti të mbetjes vakant të pozitës së rektorit, Këshilli Drejtues zgjedh ushtruesin e detyrës së rektorit deri në përfundimin e procedurës të zgjedhjes së rektorit për mandatin e mbetur. Ushtruesi i detyrës së rektorit do të mbaj postin e rektorit deri në fund të mandatit, në qoftë se deri në shpalljen e zgjedhjeve në Universitet kanë mbetur jo më shumë se 6 muaj. Ushtruesi i detyrës së rektorit zgjidhet personi që i plotëson kushtet e parapara për zgjedhjen e rektorit, neni 27 pika 3 e Statutit.

**Neni 32**

**1.** Rektori ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Ministri kundër shkarkimit të tij.
**2.** Vendimi i Ministrisë është vendim përfundimtar në procedurë administrative.
**3.** Kundër vendimit të Ministrisë mund të iniciohet procedurë në gjykatën kompetente.

**Neni 33**
**Prorektorët**

Universiteti ka më së shumti pese (5) prorektorë.

**Neni 34**

**1.** Detyrat e prorektorëve caktohen nga rektori në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. Rektori ka të drejtë t'u delegojë përgjegjësi të plotë ligjore për një kohë të caktuar. Përgjegjësi të përbashkëta mund t'u caktohen prorektorëve në fushat e:
- **1.1.** Mësimdhënies dhe çështjeve për studentë;
- **1.2.** Buxhet dhe Financa;
- **1.3.** Kërkimeve shkencore;
- **1.4.** Bashkëpunimit ndërkombëtar;
- **1.5**. Zhvillimit dhe cilësisë.

**Neni 35**

Rektori e emëron njërin nga prorektorët për të ushtruar përkohësisht detyrën e Rektorit në rast të pamundësisë apo paaftësisë së përkohshme të Rektorit.

**Neni 36**

**1.** Rektori propozon listën e emrave për prorektorë nga radha e profesorëve të Universitetit, pasi të jetë konsultuar me Senatin. Prorektorët zgjidhen nga Këshilli drejtues me shumicën absolute të votave, në një radhë votimi. Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet atëherë rektori ka të drejtë të propozojë kandidatin e ri.
**2.** Mandati i prorektorëve është i lidhur me atë të rektorit, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

**Neni 37**

**1.** Mandati i prorektorëve mund të përfundojë para kohe në rast të:

**1.1.** Dorëheqjes;
**1.2.** Shkarkimit;
**1.3.** Arsyeve shëndetësore;
**1.4.** Dënimit për vepër penale;
**1.5.** Pensionimit
**1.6.** Vdekjes.

**2.** Procedura për shkarkimin e prorektorit mund të iniciohet me shumicën absolute të votave nga:

**2.1.** Këshilli drejtues;
**2.2.** Senati;
**2.3.** Rektori.

**3.** Procedura për shkarkimin e prorektorit përcaktohet në rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues. Vendimi i Këshillit drejtues për shkarkim bëhet valid me shumicën e kualifikuar të 2/3 të votave të anëtarëve.

**4.** Në rast të shkarkimit të prorektorit, rektori propozon kandidatin e ri për prorektor, i cili zgjidhet nga Këshilli drejtues për periudhën e mbetur të mandatit.

## Neni 38
## Sekretari i përgjithshëm i Universitetit

**1.** Sekretari është zyrtari më i lartë ekzekutiv dhe administrativ i Universitetit, me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara në kontratën e tij e cila nënshkruhet nga rektori.

**2.** Sekretari i përgjigjet rektorit për administrim efikas, ekonomik dhe efektiv në të gjitha nivelet e Universitetit. Në këtë pozitë sekretari i përgjithshëm përgjigjet për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë e organeve ose e udhëheqësve të tjerë.

**3.** Sekretari i Universitetit është udhëheqës i administratës së Universitetit. Ai është udhëheqës i Administratës Qendrore të Universitetit.

## Neni 39

Sekretari i Universitetit zgjidhet nga Këshilli drejtues sipas propozimit të rektorit, të bazuar në raportin e komisionit profesional të zgjedhur nga rektori , në bazë të konkursit publik.

## Neni 40

**1.** Kandidatët që konkurrojnë për postin e sekretarit të Universitetit duhet të përmbushin këto kushte:

**1.1.** Të kenë diplomë universitare master ose ekuivalentë me më së paku katër vjet të studimeve;

**1.2.** Duhet të jenë nga fusha profesionale e drejtësisë;
**1.3.** Të kenë 5 vjet përvojë pune profesionale;
**1.4.** Të kenë aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxhuese;
**1.5.** Të kenë njohuri të mjaftueshme për proceset e arsimit, artit dhe kërkimeve;

**Neni 41**

**1.** Sekretari i përgjithshëm i Universitetit ka këto detyra dhe përgjegjësi:
**1.1.** Është zyrtari më i lartë i administratës;
**1.2.** Është udhëheqës i Administratës Qendrore;
**1.3.** Është shef i sekretarëve në fakultete;
**1.4.** Është zyrtar përgjegjës për udhëheqje efikase, ekonomike dhe efektive të Universitetit;
**1.5.** Është shef i drejtorëve të departamenteve në kuadër të Administratës Qendrore;
**1.6.** Është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike të procesit buxhetor;
**1.7.** Është përgjegjës për çështje të tjera që kërkohen nga Këshilli drejtues dhe rektori, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë Statut.

**Neni 42**
**Senati**

Senati i Universitetit është organi më i lartë akademik i Universitetit.

**Neni 43**

**1.** Senati përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:
**1.1.** Rektori;
**1.2.** Prorektorët;
**1.3.** Dekanët e të gjitha njësive akademike sipas këtij Statuti;
**1.4.** Nga një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik i secilës njësi akademike (kështu numri i përgjithshëm i personave është i njëjtë me numrin e personave të renditur në pikën 1.3 ;
**1.5.** Shtatë anëtarë të zgjedhur nga parlamenti i studentëve prej radhëve të studentëve të rregullt të Universitetit. Studentet anetare te senatit duhet te jene student te dalluar me note mesatare se paku tete (8), dhe nuk duhet te jene perserites te vitit akademik.
**1.6.** Dy anëtarë të zgjedhur nga stafi joakademik.
**2.** Sekretari i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit, pa të drejtë vote.

**Neni 44**

Mandati i anëtarëve akademikë dhe joakademikë të Senatit është katër vite. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një vit, pa te drejte te rizgjedhjes. Mandati i tyre fillon më 1 tetor.

**Neni 45**

Senatin e kryeson Rektori, në mungesë të tij , Senatin e kryeson prorektori të cilin e cakton rektori sipas radhës.

**Neni 46**

**1.** Senati nxjerr rregulloren e punës dhe rregulloren për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të tij.
**2.** Rektori cakton procedurat për mbledhjet e Senatit dhe të komisioneve të tij.

**Neni 47**

**1.** Pavarësisht nga përgjegjësitë e Këshillit drejtues dhe Rektorit, Senati është përgjegjës për:

**1.1.** Çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe kurset në Universitet, duke përfshirë:

**1.2.** Kriteret për pranimin e studentëve;

**1.3.** Miratimin e propozimeve nga Keshilli i Fakultetit per zgjedhjen dhe avansimin e personelit akademik;

**1.4.** Politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe mbajtjen e provimeve për konstatimin e punës akademike të studentëve;

**1.5.** Miratimin e përmbajtjes se planprogrameve;

**1.6.** Sigurimin e mësimit tërë jetësor;

**1.7.** Standardet akademike dhe validitetin dhe rishikimin e kurseve;

**1.8.** Sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin;

**1.9.** Procedurën për dhënien e kualifikimeve dhe të titujve akademikë të nderit;

**1.10.** Procedurën për përjashtimin e studentëve për arsye akademike apo të tjera;

**2.** Zhvillimin e strategjisë për aktivitetet akademike në Universitet dhe për mjetet e nevojshme për t'i mbështetur ato si dhe ofrimin e këshillave për rektorin dhe Këshillin drejtues;

**3.** Zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të Universitetit dhe shfrytëzimin komercial të saj;

**4.** Sigurimin e këshillave për çështje të tjera që Këshilli Drejtues ose rektori mund të kërkojnë nga Senati.

**Neni 48**

**1.** Detyrat e Senatit janë:

**1.1.** Të aprovoj Statutin e Universitetit, të propozuar nga Këshilli drejtues;

**1.2.** Të zgjedhë anëtarët e Këshillit drejtues që propozohen nga Universiteti;

1.3. Të formoj Komisionin profesional prej pese(5) anëtarëve për propozimin e listes per rektor ;

1.4. Miraton propozimin e Këshillave të njësive akademike per zgjedhjen e dekanëve dhe prodekanëve;

1.5. Të inicon proceduren per shkarkimin e dekaneve dhe prodekaneve sipas procedurës së caktuar me këtë statut;

1.6. Të lëshojë vendime për pranimin dhe shuarjen e njësive akademike dhe të propozojë ndryshime të tjera në status të tyre për miratim nga ana e Këshillit drejtues;
1.7. Të miratojë programet e studimeve të njësive akademike;
1.8. Të përpilojë strategji për zhvillimin akademik të Universitetit;
1.9. Të nxjerrë rregullore të përgjithshme për fushat e punës arsimore, kërkimore dhe artistike;
1.10. Të caktojë procedura dhe kritere për vlerësimin e mësimdhënies, punës shkencore dhe artistike;
1.11. Të propozojë kriteret për regjistrimin e studentëve, në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin mbi Arsimin e Lartë;
1.12. Të vendos për kriteret për përjashtimin e studentëve;
1.13. Të definojë standardet akademike për ligjërata dhe për sigurim të cilësisë së mësimeve, në pajtim me këtë Statut;
1.14. Të vendosë për kriteret e provimit;
1.15. Të përcaktojë përmbajtjen e të gjitha të dhënave akademike dhe dokumentacionit sipas këtij Statuti;
1.16. Të vendosë procedurën për vlerësimin e personelit akademik në përputhje me këtë Statut;
1.17. Të zgjedhë anëtarët për të gjitha komisionet dhe këshillat që i formon Senati;
1.18. Të marrë vendimet përfundimtare duke i marrë parasysh kundërshtimet e dhëna nga këshillat e njësive akademike;
1.19. Të vendosë për dhënien e titullit Dr. honoris causa;
1.20. Të vendosë për dhënien e titullit Profesor emeritus sipas dispozitave të këtij Statuti.
1.21. Të vendosë për dhënien e titullit Anëtar Nderi i Universitetit;
1.22. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të Këshillit drejtues apo rektorit;
1.23. Te shqyrtoj qeshtjet me propozim te Keshillit te njesise akademike ;
1.24. Të shqyrtojë çështjet, me kërkesë të parlamentit të studentëve;
1.25. Të nxjerrë rregulloren e punës së Senatit;
1.26. Të shqyrtojë çështje të tjera siç përcaktohen nga ky Statut ose me kërkesën e Këshillit drejtues, rektorit, këshillave të fakulteteve ose Parlamentit Studentor.

**Neni 49**

**1.** Senati mund të formojë këshilla ose komisione të përkohshme për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.

**2.** Senati ka një komision të përhershëm, të quajtur Komisioni i studimeve, sipas dispozitave të këtij Statuti.

**Neni 50**
**Struktura organizative**

**1.** Universiteti përbëhet prej:
1.1. Njësive akademike;
1.2. Njësive organizative.

**Neni 51**

Njësitë akademike dhe Njësitë organizative nuk kanë subjektivitet juridik.

**Neni 52**
**Njësitë akademike**

**1.** Njësitë akademike të Universitetit janë:
  **1.1.** Fakulteti;
  **1.2.** Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe
  **1.3.** Fakulteti i edukimit.

**Neni 53**

Njësitë akademike kanë status të njëjtë sipas dispozitave që rregullojnë organizimin në këtë statut.

**Neni 54**

Njësia akademike vepron në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit duke ofruar programe të arsimit të lartë, kërkime shkencore ose krijimtari artistike.

**Neni 55**

Njësitë akademike krijohen me anë të integrimit apo shpërbërjes së njësive të tjera me vendim të Këshillit drejtues dhe pas konsultimeve me Senatin.

**Neni 56**

**1.** Parakushtet për të fituar statusin e një njësie akademike janë:
  1.1. Veprimtaria në një apo në më shumë fusha të veçanta të arsimit akademik, në kërkime shkencore apo në krijimtari artistike në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit;
  1.2. Infrastruktura e mjaftueshme;
  1.3. Numri i duhur i personelit akademik që mundëson plotësimin e kërkesave akademike për një periudhë afatgjatë,
**2.** Këshilli drejtues merr vendimin përfundimtar.

**Neni 57**

**1.** Njësia akademike humb statusin nëse:
  1.1. Vlerësohet negativisht nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dy herë radhazi;
  1.2. I nënshtrohet integrimit apo shpërbërjes;
  1.3. Këshilli i kësaj njësie akademike kërkon shkëputjen institucionale nga Universiteti. Këshilli drejtues merr vendimin përfundimtar.

**Neni 58**

Këshilli drejtues vendos për buxhetin vjetor të njësisë akademike sipas propozimit të rektorit dhe dëgjimit buxhetor me njësinë akademike. Gjatë ndarjes së buxhetit duhet të merren parasysh nevojat e veçanta për obligimet mësimore, kërkimore dhe artistike, si dhe rezultatet e raporteve të mëhershme të punës dhe vlerësimet e njësive akademike.

**Neni 59**

Njësia akademike ka në dispozicion një përqindje përkatëse vjetore të tarifave të studentëve për të përmirësuar cilësinë arsimore si dhe për të mbuluar shërbimet e paparashikuara të personelit arsimor. Këshilli drejtues nxjerr rregulloret përkatëse.

**Neni 60**

**1.** Për detyrimet arsimore, të cilat financohen nga fondet publike, Universiteti i cakton njësisë akademike një numër të caktuar të personelit akademik dhe joakademik dhe i siguron infrastrukturën e duhur në përputhje me detyrimet arsimore të përcaktuara nga Këshilli drejtues me propozimin e Senatit.
**2.** Njësia akademike si anëtare e Universitetit është përgjegjëse për zbatimin e programeve të studimeve të akredituara në kuadër të profilit të saj arsimor dhe në përputhje me dispozitat e arsimit të lartë. Senati i cakton programet e studimeve.
**3.** Njësia akademike është përgjegjëse për zhvillimin e kërkimeve shkencore dhe për punën artistike në kuadër të fushëveprimtarisë së saj.
**4.** Programet interdisiplinare të studimeve, që përfshijnë disa njësi akademike, do të themelohen me vendim të Senatit dhe sipas propozimeve të njësive akademike pjesëmarrëse.

**Neni 61**

**1.** Njësia akademike ka emrin dhe vulën e vet.
**2.** Njësia akademike mban emblemën dhe emrin e Universitetit brenda emblemës dhe emrit të vet.

**Neni 62**
**Fakulteti**

**1.** Fakulteti është i angazhuar në disiplinat akademike të:
- 1.1. Arsimimit akademik;
- 1.2. Kërkimit shkencor;
- 1.3. Krijimtarisë artistike;
- 1.4. Aktiviteteve të tjera të përcaktuara me këtë Statut.

**Neni 63**

**1.** Fakulteti ofron këto lloje të studimeve:
1.1. Studimet themelore – bachelor ;
1.2. Studimet master :
1.2.1 Master shkencore dhe
1.2.2 Master profesional, të cilet nuk mund të regjistrohen në studimet e doktoratës shkencore.
1.3. Studimet e doktoratës.

**2.** Fakulteti i Mjekësisë në nivelin themelor ofron këto lloje të studimeve:
2.1. Studime themelore gjashtëvjeçare (mjekësi e përgjithshme, stomatologji dhe farmaci).
2.2. Studime bachelor trevjeçare (fizioterapi, infermieri dhe mami).

**Neni 64**

**1.** Në përbërjen e vet Universiteti i ka këto fakultete:
1.1. Fakulteti Filozofik;
1.2. Fakulteti i Shkencave Matematike- Natyrore;
1.3. Fakulteti i Filologjisë;
1.4. Fakulteti Juridik;
1.5. Fakulteti Ekonomik;
1.6. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës;
1.7. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
1.8. Fakulteti I Inxhinierisë Mekanike;
1.9. Fakulteti i Mjekësisë;
1.10. Fakulteti i Arteve;
1.11. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
1.12. Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë;
1.13. Fakulteti i Shkencave Sportive;

**Neni 65**

**1.** Pavarësisht prej madhësisë (numrit të përgjithshëm të personelit akademik, numrit të mjaftueshëm të profesorëve të rregullt sipas nevojës së fushave të ndryshme akademike dhe përqindjes së personelit të përhershëm), fakulteti duhet t'i plotësojë standardet ndërkombëtare (përmasat kritike) në mënyrë që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe veprimtari profesionale në të gjitha fushat shkencore për një periudhë afatgjate.
**2.** Fakulteti e përqendron profilin e vet arsimor dhe kërkimor për nevojat e vendit, në riaftësimin dhe për mësimin gjatë gjithë jetës të profesionistëve, si dhe ofron shërbime praktike për partnerët vendorë.
**3.** Fakulteti ka të drejtë të themelojë institute për kërkime praktike në fusha të caktuara, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët privatë ose publikë, me miratim të Këshillit drejtues.
**4.** Këshilli drejtues nxjerr rregullore mbi organizimin e brendshëm të njësive akademike me propozim të këshillit të njësisë akademike përkatëse.

**5.** Njësitë akademike kanë të drejtë të krijojnë këto nivele të nënndarjes hierarkike:
5.1. Departamentet (fusha të përgjithshme të shkencës apo arteve);
5.2. Institutet (fusha speciale të shkencës apo arteve),
5.3. Njesite hulumtuese.

**Neni 66**

**1.** Fakulteti është përgjegjës për sa vijon:
1.1. T'i propozojë Senatit programet e studimeve;
1.2. Të organizojë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimet e studentëve;
1.3. Progresin akademik të studentëve, duke përfshirë shërbimet akademike të studentëve;
1.4. Të zhvillojë kërkime shkencore apo krijimtari artistike sipas standardeve ndërkombëtare;
1.5. Të sigurojë cilësinë, vlerësimin dhe çështjet e raportimit, siç është paraparë me këtë Statut;
1.6. Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet, siç është paraparë me këtë Statut;
1.7. Çështjet e personelit sipas dispozitave të këtij Statuti;
1.8. Të përdorë drejt dhe në mënyrë efikase mjetet e alokuara nga Këshilli drejtues.

**Neni 67**

**1.** Çdo fakultet udhëhiqet nga dekani të cilin, sipas vendimit të Senatit, mund ta ndihmojnë një, dy ose tre prodekanë.
**2.** Fakultetet që veprojnë në më shumë se një lokacion, kanë të drejtë edhe për nga një prodekan për secilin lokacion.

**Neni 68**

**1.** Dekanët dhe prodekanët zgjedhen nga Keshilli i njesise akademike me shumicën absolute të votave dhe i propozon Senatit per miratim për një periudhë katërvjeçare, nga radha e profesorëve të fakultetit përkatës, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.
**2.** Kandidatët për postin e dekanit dhe të prodekanit duhet të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi dhe përvojë në udhëheqje si dhe të kenë së paku thirrjen e profesorit asistent.
**3.** Dekani i zgjedhur i propozon Këshillit te njësisë akademike prodekanët e mundshem për mandatin e përbashkët të cilët zgjedhen ne Keshill dhe i percillen Senatit per miratim.
**4.** Për zgjedhjen e dekanit të ri, këshilli i njesise akademike zgjedh një delegat nga profesorët e fakultetit, i cili përkohësisht mban mandatin e dekanit në Senat derisa të përfundojë procedura e zgjedhjes së dekanit të ri. Pastaj dekani i ri merr mandatin ashtu siç parashihet me këtë Statut.
**5.** Mandati i rregullt i dekanit dhe i prodekanëve fillon me një (1) tetor.

**Neni 69**

Autoriteti i dekanit simbolizohet me zinxhirin e dekanit.

**Neni 70**

**1.** Mandati i dekanit mund të përfundojë para kohe në rast të:
  1.1. Dorëheqjes;
  1.2. Shkarkimit;
  1.3. Arsyeve shëndetësore;
  1.4. Dënimit për vepër penale;
  1.5. Pensionimit
  1.6. Vdekjes.
**2.** Procedura për shkarkimin e dekanit mund të iniciohet nga:
  2.1. Këshilli drejtues;
  2.2. Senati;
  2.3. Rektori;
  2.4. Këshilli i fakultetit përkatës.
**3.** Procedura dhe arsyet për shkarkimin e dekanit përcaktohen në rregulloren e nxjerrë nga Senati.
**4.** Vendimi për shkarkimin e dekanit merret nga Senati pasi të jetë bërë konsultimi me këshillin e fakultetit përkatës. Vendimi i Senatit merret me shumicën e kualifikuar të 2/3 të anëtarëve.
**5.** Në rast të përfundimit të mandatit të dekanit përfundon edhe mandati i prodekanëve.
**6.** Ne rast të përfundimit të mandatit, dekani dhe prodekanët e posa zgjedhur do të zgjidhen për periudhën e mbetur të mandatit.

**Neni 71**

**1.** Mandati i prodekanit mund të përfundojë para kohe në rast të:
  1.1. Dorëheqjes;
  1.2. Shkarkimit;
  1.3. Arsyeve shëndetësore;
  1.4. Dënimit për vepër penale;
  1.5. Pensionimit
  1.6. Vdekjes.
2. Procedura për shkarkimin e prodekanit mund të iniciohet nga:
  2.1. Këshilli Drejtues;
  2.2. Senati;
  2.3. Rektori;
  2.4. Këshilli i fakultetit përkatës;
  2.5. Dekani.
3. Vendimi për shkarkim merret nga Senati pasi të jetë konsultuar me dekanin dhe këshillin e fakultetit përkatës. Vendimi i Senatit për shkarkim nga posti merret me shumicën e kualifikuar të 2/3 të anëtarëve.

4. Në rast të përfundimit të mandatit të prodekanit, dekani propozon kandidatin e ri në detyrën e prodekanit, i cili zgjidhet për periudhën e mbetur të mandatit të prodekanit të shkarkuar.

**Neni 72**

1. Dekani për punën e tij i përgjigjet rektorit. Detyrat e dekanit janë:
   1.1. Të sigurojë udhëheqje akademike në fushat përkatëse për zhvillimin e mësimit, punës shkencore dhe artistike në fakultet;
   1.2. Të sigurojë shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe efektiv të mjeteve të alokuara për fakultetin nga Këshilli drejtues;
   1.3. Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në zbatimin e vendimeve dhe detyrave të përcaktuara nga Këshilli i fakultetit;
   1.4. Të sigurojë informata të mjaftueshme në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve dhe rezultateve në mësim, në kërkime shkencore dhe në krijimtari artistike për rektorin dhe Këshillin drejtues sipas dispozitave të këtij Statuti;
   1.5. Të përfaqësojë Këshillin e Fakultetit në Senatin e Universitetit;
   1.6. T'i japë këshilla rektorit dhe Senatit për emërimin e personelit akademik në lëndët e fakultetit;
   1.7. Të propozojë kandidatët për prodekanë;
   1.8. T'i kryejë detyrat e tjera të dekanit që parashihen në këtë Statut.
2. Dekani mund të përfaqësojë Universitetin edhe për çështjet ligjore në emër të fakultetit vetëm me autorizim të Këshillit drejtues të paraparë me rregullore apo me mënyrë tjetër.
3. Dekani i përcakton detyrat e prodekanit.

**Neni 73**

1. Çdo fakultet ka këshillin, anëtarët e të cilit janë:
   1.1. Dekani;
   1.2. Prodekani (ët);
   1.3. Sekretari i Fakultetit;
   1.4. Deri në tridhjetë (30) anëtarë të zgjedhur nga radha e profesorëve të fakultetit;
   1.5. Deri në 8 anëtarë të zgjedhur nga radha e asistentëve të fakultetit;
   1.6.Një anëtar i zgjedhur nga personeli joakademik i fakultetit;
   1.7. Dy përfaqësues te studentëve, të zgjedhur nga këshilli i studentëve të fakultetit.

**Neni 74**

Mandati i anëtarëve akademikë dhe joakademikë të këshillit është katër vjet. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një vit. Mandati i tyre fillon më një (1) tetor.

**Neni 75**

1. Dekani e kryeson Këshillin e fakultetit. Në mungesë të dekanit, një nga prodekanët kryeson këshillin sipas radhës së përparësisë të caktuar nga dekani.
2. Dekanet e fakulteteve formojne Kolegjiumin e dekaneve te cilin e udheheq Rektori. Kolegjiumit i dekaneve nxjerr rregullore te veqant per organizimin e punes se vet.

## Neni 76

**1.** Këshilli i fakultetit ka këto përgjegjësi dhe detyra:

1.1. Të propozojë kandidatin për postin e dekanit për t'u miratuar nga Senati;

1.2. T'i japë këshilla dhe propozime Këshillit Drejtues dhe Senatit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fakultetin, personelin e tij, strukturën dhe organizimin e brendshëm;

1.3. T'i propozoj Senatit planprogramet dhe ndryshimet në planprograme, të japë rekomandime në metoda të mësimdhënies, në fusha të studimeve shkencore apo të punës artistike dhe për çështje të tjera akademike;

1.4. Të mbikëqyrë progresin e studentëve si dhe të kërkimeve shkencore apo të krijimtarisë artistike në fakultet;

1.5. Të propozon numrin dhe të përcakton kushtet për regjistrim të studentëve të rinj, në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga Këshilli drejtues dhe Senati;

1.6. Të përcaktojë dhe zbatojë masat e duhura për sigurimin e cilësisë dhe për vlerësim në përputhje me udhëzimet e përcaktuara nga Senati;

1.7. Të hartojë raportet vjetore të punës për rektorin;w

1.8. Të merret me çështje tjera që ndërlidhen me çështje akademike;

1.9. Të merret me çështje të tjera të cilat janë të përcaktuara me këtë Statut ose që kërkohen nga Këshilli drejtues apo Senati.

## Neni 77

1. Çdo fakultet ka Këshillin e studentëve. Ky është autoritet që i përfaqëson të gjithë studentët e fakultetit.
2. Numri i anëtarëve dhe procedura për zgjedhjen e tyre caktohet me rregulloren e nxjerrë nga Këshilli Drejtues në pajtim me këtë statut dhe ne konsultim me Parlamentin e Studenteve.
3. Mandati i anëtarëve të Këshillit të studentëve është i kufizuar në dy vite pa mundësi për rizgjedhje.

## Neni 78

1. Këshilli i studentëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve në fakultet.
2. Këshilli i studentëve realizon interesat e veta, lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, përmes përfaqësuesve të vet në këshillin e fakultetit.
3. Anëtarët studentë të këshillit të fakultetit marrin pjesë në propozimin e kandidatëve për dekan.

## Neni 79
## Fakulteti i Shkencave të Aplikuara

1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara është njësi akademike e Universitetit e angazhuar për mësimdhënie dhe për kërkime të aplikuara shkencore në disiplinat akademike përkatëse. Mësimdhënia akademike e tij përqendrohet në programet e studimeve të orientuara në praktikë, duke ndjekur konceptin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Evropës.

2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara e përqendron profilin e vet arsimor dhe kërkimor për nevojat e vendit, në riaftësimin dhe për mësimin gjatë gjithë jetës të profesionistëve, si dhe ofron shërbime praktike për partnerët vendorë.
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka të drejtë të themelojë institute për kërkime praktike në fusha të caktuara, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit me donatorët privatë ose publikë, me miratim të Këshillit drejtues.

**Neni 80**

1. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ofron këto lloje të studimeve:
   1.1. Studimet themelore - bachelor;
   1.2. Studimet master; profesionale (të diplomuarit në master profesional nuk mund të regjistrohen në studimet e doktoratës shkencore) dhe shkencor.

**Neni 81**

1. Në përbërjen e vet Universiteti i ka këto fakultete të shkencave të aplikuara:
   1.**1.** Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Mitrovicë;
   **1.2.** Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

**Neni 82**

Të gjitha rregullat e tjera në lidhje me fakultetin e shkencave të aplikuara janë të ngjashme me kapitullin 'Fakultetet' (neni 62) të këtij Statuti.

**Neni 83**
**Njësitë organizative**
**Biblioteka Qendrore Universitare**

Biblioteka Qendrore Universitare është njësi organizative në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

**Neni 84**

1. Biblioteka Qendrore Universitare mbledhë, përpunon dhe ofron në përdorim koleksione mësimore, materiale, informacione dhe shërbime bibliotekare për zhvillimin e veprimtarisë arsimore, shkencore si dhe për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të studentëve e mësimdhënësve të tyre.
2. Biblioteka Qendrore Universitare ofron shërbime për studentët dhe personelin mësimor duke iu dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit. Ofron shërbime profesionale për bibliotekat e fakulteteve përkatëse. Veprimtaria e bibliotekave universitare mbështetet në standardet ndërkombëtare bibliotekare.
3. Biblioteka Qendrore Universitare është pjesë përbërëse e Rrjetit të njësuar Bibliotekar të Kosovës me qëllim të zbatimit të standardeve bibliotekare, përgatitjes dhe shpërndarjes së bazës së të dhënave dhe begatimit e bashkërenditjes së bashkëpunimit ndërbibliotekar.

**Neni 85**

1. Struktura e Bibliotekës Qendrore Universitare përbëhet prej Këshillit Drejtues dhe Drejtorit.
2. Këshilli Drejtues i Bibliotekës Qendrore Universitare ka 5 anëtarë të cilët i emëron dhe i shkarkon rektori i universitetit.
3. Këshilli Drejtues ka këto detyra dhe përgjegjësi:
   3.1. Harton dhe aprovon strategjitë dhe politikat zhvillimore të bibliotekës;
   3.2. Aprovon planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar të bibliotekës;
   3.3. Aprovon raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të bibliotekës;
   3.4. Harton statutin e bibliotekës, të cilin e miraton themeluesi;
   3.5. Harton dhe miraton rregulloren e punës së vet;
   3.6. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin me shumicë absolute të votave të anëtarëve.
   3.7. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e bibliotekës;
   3.8. I raporton dhe i përgjigjet për punën e tij organit që e emëron.
4. Drejtori i Bibliotekës Qendrore Universitare zgjidhet me konkurs publik sipas Ligjit per Bibliotekat. Mandati i drejtorit është 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Drejtori udhëheq, organizon dhe mbikëqyrë veprimtarinë dhe funksionimin e bibliotekës. Drejtori i Bibliotekës Qendrore Universitare, sipas Ligjit për Bibliotekat në Republikën e Kosovës është anëtar i Këshillit Kombëtar të Bibliotekave, si organ këshillëdhënës i Ministrisë përkatëse për kulturë. I propozon Këshillit Drejtues planin vjetor dhe planin financiar. Për punën e tij i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote. Përfaqëson bibliotekën brenda dhe jashtë vendit. Ushtron detyra dhe autorizime tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 86**

1. Në kuadër të Universitetit mund të themelohen edhe njësi tjera organizative.
2. Njësitë tjera organizative themelohen me vendimin e Këshillit drejtues, propozimin për themelim mund ta bënë edhe rektori.
3. Struktura e njësive tjera organizative përbëhet prej Këshillit Administrativ dhe Drejtorit.
4. Këshilli Administrativ është i përbërë prej pesë anëtarësh, tre prej tyre i zgjedh Këshilli drejtues i UP – së dhe dy zgjidhen nga radha e personelit të njësisë organizative. Të gjithë anëtarët zgjidhen për tri vite.

**Neni 87**
**Studentët dhe organizimi i studimeve**
**Studimet dhe programet e studimeve**

1. Studimet në Universitet përcaktohen në kuadër të programeve të studimeve.
2. Përmbajtja e programeve për të gjitha llojet e studimeve të përfshira në këtë Statut bëhet në bazë të rregulloreve të përgatitura nga këshillat e njësive akademike në bazë të sugjerimeve të komisionit të studimeve dhe miratohen nga Senati.
3. Përmbajtja e programeve të studimeve për mësimdhënie përcaktohet me rregulloret e përgatitura nga këshilli akademik i fakultetit përkatës, me sugjerim të komisionit të

studimeve dhe aprovohet nga Senati në pajtim me nenin 16.4 të Ligjit për Arsim të lartë të Republikës së Kosovës dhe në harmoni me standardet e përcaktuara nga Ministria.

**Neni 88**

1. Universiteti ofron këto lloje të studimeve:
   1.1. Studimet themelore - bachelor;
   1.2. Studimet master; profesionale dhe shkencor (të diplomuarit në master profesional nuk mund të regjistrohen në studimet e doktoratës shkencore)
   1.3. Studimet e doktoratës.

**Neni 89**

1. Universiteti ofron programe të studimeve akademike në këto fusha;
   1.1. Në shkencat sociale dhe humane;
   1.2. Në shkencat e edukimit;
   1.3. Në shkencat teknike dhe të inxhinierisë;
   1.4. Në shkencat natyrore, matematike dhe bioteknikë;
   1.5. Në mjekësi, veterinari
   1.6. Në arte;
   1.7. Në ekonomi;
   1.8. Në drejtësi.

**Neni 90**

1. Programet e studimit përmbajnë:
   1.1. Titullin e studimit;
   1.2. Llojin e studimit ;
   1.3. Thirrjen akademike (Titullin akademik);
   1.4. Kushtet për regjistrim ;
   1.5. Objektivat dhe rezultatet;
   1.6. Hollësitë mbi planprogramin;
   1.7. Vlera në pikë sipas ECTS (Lëndët, punimi i diplomës);
   1.8. Kushtet për studime individuale.
2. Përmbajtjet obligative të planprogramit do të përcaktohen me rregullore të nxjerra nga Senati.

**Neni 91**

1. Studimet bachelor zgjasin 3 ose 4 vjet dhe kërkojnë 180 respektivisht 240 pikë të ECTS-së.
2. Senati nxjerr rregullore të veçanta për studimet themelore në fushën e Mjekësisë dhe Mjekësisë Veterinare me propozimin e këshillit të fakultetit përkatës. Këto programe zgjasin deri në 6 vjet dhe kërkojnë deri në 360 pikë të ECTS-së.
3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve bachelor fitohet thirrja akademike bachelor i shkencës apo bachelor i arteve.

4. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve sipas pikës 2 fitohet titulli doktor i mjekësisë dhe doktor i veterinës.

**Neni 92**

1. Studimet master zgjasin 1 respektivisht 2 vjet dhe kërkojnë 60 respektivisht 120 pikë të ECTS-së.
2. Përfundimi me sukses i studimeve themelore – bachelor është kusht për regjistrimin e studimeve master.
3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet thirrja akademike master i shkencës, master profesional apo master i arteve.

**Neni 93**

1. Studimet e doktoratës janë studimet me të larta akademike.
2. Studimet e doktoratës zgjasin zakonisht 3 vjet, dhe kërkojnë 180 pikë të ECTS-së dhe përfundim me sukses të studimeve të mëparshme me më së paku 300 pikë të ETCS-së.
3. Kusht për fitimin e titullit doktor shkence është përfundimi me sukses i studimeve të doktoratës dhe mbrojtja me sukses e tezës së doktoratës para komisionit te mbrojtjes.

**Neni 94**

1. Njësitë akademike të Universitetit kanë të drejtë të themelojnë programe të veçanta për studim brendapërbrenda kornizës së Bolonjës (bachelor-master-doktoratë):
   1.1. Për programet dylëndore të studimeve;
   1.2. Për programet ndërdisiplinare të studimeve;
   1.3. Për programet e përbashkëta të studimeve.

**Neni 95**

1. Programet dylëndore të studimeve ofrohen nga njësitë akademike në një program të përbashkët të studimeve dhe përmbajnë dy fusha të studimeve të po kësaj njësie.
2. Përgjegjësitë e secilit partner kontribuues përcaktohen në programin e studimeve.
3. Programin e studimeve e propozon Këshilli i njësisë akademike dhe aprovohet nga Senati.
4. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve fitohet diploma e përbashkët dhe studenti i diplomuar fiton thirrjen profesionale në të dy fushat e studimit.

**Neni 96**

1. Programet e studimeve ndërdisiplinare përcaktohen nga Senati, ndërsa propozohen nga dy apo më shumë njësi akademike për të tri nivelet e studimit.
2. Përgjegjësitë e secilit partner përcaktohen në programin e studimit.
3. Senati themelon Komisionin për studime ndërdisiplinore, i cili është përgjegjës për:
3.1. Zhvillimin e programit të studimeve;
3.2. Çështjet organizative dhe teknike;

3.3. Procedurat për realizim.
4. Te gjitha propozimet e Komisionit të studimeve duhet të aprovohen nga Këshillat e të gjitha njësive akademike të cilat kontribuojnë në programin e studimit.
5. Senati merr vendimin përfundimtar për të gjitha rregulloret e studimeve, të propozuara nga komisioni i studimeve dhe të aprovuara nga këshilli i njësive akademike.

**Neni 97**

1. Programet e përbashkëta të studimeve mund të zhvillohen në mes të Universitetit të Prishtinës dhe të Universiteteve të tjera në bazë të kontratave për partneritet.
2. Programet e përbashkëta të studimeve përcaktohen nga Senati dhe ofrohen nga njësitë akademike për të tri nivelet.
3. Obligimet e secilit Institucion partner përcaktohen në programin e studimeve në bazë të marrëveshjes së përbashkët institucionale.
4. Senati bën zgjedhjen e anëtarëve për komisionin e studimit të përbashkët ndër-universitar, i cili është përgjegjës për:
   4.1. Zhvillimin e programit të studimeve;
   4.2. Çështjet organizative dhe teknike;
   4.3. Procedurat për realizim.
5. Të gjitha propozimet e Komisionit të studimeve duhet të aprovohen nga këshillat e të gjitha njësive akademike të të gjitha universiteteve, të cilat kontribuojnë në studim.
6. Senati merr vendimin përfundimtar për të gjitha rregulloret e studimeve, të propozuara nga Komisioni i studimeve.

**Neni 98**

1. Studentët kanë të drejtë të paraqitën në një program individual të studimeve të quajtura ‘studium irregulare (studime individuale)’. Skema kryesore e ‘studium irregulare’ përfshin një nga programet e rregullta te studimeve (programin bazë të studimit) të ofruar nga një njësi akademike. Numri i përgjithshëm i lëndëve të zgjedhura në mënyrë individuale në krahasim me programin bazë të studimit nuk duhet të tejkalojë 30% (e matur në vlerën e pikëve të ECTS-së).
2. Lëndët zgjedhore individuale mund të zgjidhen nga të gjitha njësitë akademike të Universitetit.
3. Propozimet për „studium irregulare“ duhet t`i drejtohen komisionit të studimeve të njësisë akademike, prej nga është bazuar programi bazë mësimor duke përfshirë këto elemente:
   3.1. Titulli i studimit;
   3.2. Ndjekja e programit të studimeve të rregullta;
   3.3. Objektivat dhe rezultati i procesit të studimit;
   3.4. Detajet e planprogramit;
   3.5. Vlera në pikë të ECTS-së (lëndët, punimi i diplomës);
4. Komisioni i studimeve vendos për:
   4.1. Pranimin e ‘studium irregulare’ sipas versionit të prezantuar;
   4.2. Refuzimin e propozimeve për studium irregulare;
   4.3. Kthimin prapa të propozimeve të ’studium irregulare’ për ndryshim apo plotësim.

5. Nëse Komisioni i studimeve i përgjigjet pozitivisht, këshillat e njësive akademike miratojnë ‚studium irregulare'.

## Neni 99

1. Njësitë akademike kanë të drejtë të ofrojnë lëndë akademike për publikun në tërësi.
2. Lëndët universitare përfshijnë:
   2.1. Kurse bazë;
   2.2. Kurse të specializuara;
   2.3. Seminaret;
   2.4. Shkolla verore.
3. Planprogrami, parakushtet për vijim dhe çështjet e tjera organizative aprovohen nga këshillat e njësive akademike sipas propozimeve të profesorit i cili është përgjegjës për lëndën. Vendimi përfundimtar merret nga Senati.
4. Me përfundimin e suksesshëm të kursit universitar fitohet certifikata e nënshkruar nga dekani i njësisë akademike në të cilën është zhvilluar lënda dhe nga profesori përgjegjës për lëndën.

## Neni 100
## Komisioni i studimeve

1. Komisioni i studimeve themelohet në çdo njësi akademike të Universitetit si organ këshillëdhënës për këshillin e kësaj njësie akademike.
2. Komisioni i studimeve themelohet për secilin program ndërdiciplinar dhe program të përbashkët të studimeve të Universitetit, si organ këshillëdhënës për Senatin, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

## Neni 101

1. Komisioni i studimeve është përgjegjës për:
   1.1. Hartimin e propozimeve të programeve të reja të studimeve;
   1.2. Përshtatjen dhe ndryshimin e programeve ekzistuese të studimit;
   1.3. Rishikimin e vazhdueshëm të teksteve universitare;
   1.4. Kërkesat për ndërrimin e programeve të studimeve nga studentët;
   1.5. Kërkesat për ‚studium irregulare' nga studentët;
   1.6. Përgatitjen e lëndës për ankesat e studentëve;
   1.7. Vlerësimin e studentëve.
2. Detyrat e Komisionit të studimeve janë: zhvillimi i koncepteve, vlerësimi dhe komentimi i kërkesave në mënyrë që të përgatis raporte për të cilat vendoset në Senat apo në Këshillin e njësisë përkatëse.

## Neni 102

1. Anetaret e Komisionit te studimeve nuk duhet të jenë doemos anëtarë të Senatit apo të këshillit të njesise akademike. Komisioni i studimeve ka kete perberje :
   1.1. Prorektori ose prodekani për mësim (kryesues);
   1.2. Pesë profesorë;

1.3. Një asistentë;

1.4. Dy studentë me note mesatare se paku tete (8).

2. Anëtarët e personelit akademikë zgjidhen nga Senati ose këshilli i njesise akademike.

3. Anëtari student zgjidhet nga parlamenti i studentëve respektivisht Këshilli i studentëve.

4. Kohëzgjatja e mandatit është në pajtim me rregulloret e Senatit për anëtarë, ashtu siç është e përcaktuar në këtë Statut.

**Neni 103**
**Pranimi në studime**

1. Secili kandidat që e kalon testin e maturës, gëzon të drejtën për të konkurruar për studime në Universitetin e Prishtinës sipas legjislacionit ne fuqi.

2. Kushtet për pranim në studimet themelore – bachelor në Universitet janë:

2.1. Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë i vërtetuar me diplomë;

2.2. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse;

2.3. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku 12 vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse të fituar në botën e jashtme, në qoftë se është bërë barasvlerësimi me diplomën e maturës. Vendimi për njohjen e diplomës dhe barasvlerën merret nga Ministria përkatëse.

**3.** Senati nxjerr rregullore, të cilat përcaktojnë në hollësi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – bachelor.

**4.** Për fusha të veçanta studimi, Universiteti organizon provime shtesë – provim pranues për disa lëndë, në procedurën e pranimit të studentëve, të cilat duhet të aprovohen nga Ministria. Në këtë rast studenti duhet të kaloj me sukses provimin pranues për regjistrim në vitin e parë të studimeve.

**Neni 104**

1. Studentët në studime Master pranohen mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

2. Kriteret e posaçme për pranim në studimet master do të caktohen nga Senati në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

**Neni 105**

1. Numri i vendeve për studime bachelor dhe master përcaktohet nga Senati për çdo vit të parë të studimit në secilën njësi akademike, me propozimin e këshillit përkatës. Vendimi bazohet në numrin e përgjithshëm të studentëve që do të shkollohen me shpenzime publike të ofruara nga ana e Ministrisë.

2. Studentët me korrespondencë, të studimeve bachelor dhe master, të cilët nuk financohen nga fondet publike por që arrijnë rezultate të shkëlqyera në mësim mund t'iu akordohet një vend studimi i cili financohet nga fondet publike nga viti i dytë i studimit,

ose në vitin vijues të studimit. Kushtet dhe kriteret për të fituar këtë të drejtë i përcakton Këshilli drejtues në propozim të Senatit.

**Neni 106**

Rregullat për shpalljen e konkursit dhe kriteret për regjistrim nxirren nga Senati.

**Neni 107**

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjes.
2. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni 5 anëtarësh, kryesuar nga prorektori për mësim dhe çështje të studentëve dhe me anëtarë të tjerë të emëruar nga rektori.

**Neni 108**
**Përcaktimi i suksesit akademik**

1. Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:
   1.1. Provimi;
   1.2. Kolokviumi;
   1.3. Punimi seminarik;
   1.4. Praktika profesionale;
   1.5. Testi praktik gjatë ushtrimeve;
   1.6. Interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera.

**Neni 109**

1. Të gjitha njësitë akademike të Universitetit do të zbatojnë këto nota për të përshkruar nivelin e suksesit në provime:
   **1.1.** 10 dhe 9 (shkëlqyeshëm)
   1.2. 8 (shume mire)
   **1.3.** 7 (mirë)
   **1.4.** 6 ( mjaftueshëm)
   **1.5.** 5 (pamjaftueshëm)
2. Kandidati kalon provimin me sukses me notat 6 – 10.
3. Senati nxjerr rregulloren për përcaktimin e kritereve të hollësishme për notim.

**Neni 110**

1. Provimet shërbejnë si mënyrë e rregullt e vlerësimit të dijes.
2. Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë ose të kombinohen për më shumë lëndë në pajtim me programin e studimeve (provim me komision).
3. Provimet janë publike dhe mbahen në këto mënyra:
   3.1. Me shkrim;
   3.2 . Me gojë;

3.3. Me shkrim dhe me goje
3.4. Praktike.
4. Provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim bëhen brenda shtatë ditëve.
5. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose nga një komision për provime.
6. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
6.1. Studenti është ankuar;
6.2. Është caktuar me programin e studimeve.
7. Procedura e mbajtjes së provimit është e përcaktuar me programin e studimit.
8. Mënyra e përcaktimit të dijes dhe të dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.

**Neni 111**

1. Provimet për studimet bachelor dhe master mbahen gjatë afatit të provimeve.
2. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit). Periudha e saktë për çdo afat është e përcaktuar me kalendarin e përgjithshëm të studimeve, i cili është i pranuar nga Senati dhe i hapur për publikun. Hollësitë rreth datës së fillimit dhe përfundimit të secilit afat të provimeve përcaktohen nga këshillat e njësive akademike.
3. Oraret e afateve të provimeve, ku janë të përfshira oraret ditorë, shpallen në fillim të vitit akademik.
4. Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.
5. Oraret e provimeve, pasi të jenë shpallur, janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.

**Neni 112**

Provimet në studimet e doktoratës mund të mbahen gjatë gjithë vitit akademik sipas marrëveshjes individuale ndërmjet pyetësit dhe studentit.

**Neni 113**

1. Koha e paraqitjes së provimit do të fillojë jo më herët se 6 javë para përfundimit dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të afatit të provimit.
2. Orari i provimit duhet të shpallet jo më vonë se tri ditë para datës së provimit.
3. Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet që ka dështuar (është notuar me 5).
4. Me kërkesë të tij, studentit mund t'i lejohet, nga dekani i njësisë akademike që të hyjë më herët në provim po qe se merr pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është duke bërë mësimin praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

**Neni 114**

1. Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim dekanit të njësisë akademike kundër notës së marrë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi te jenë shpallur rezultatet.
2. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:
   2.1. Për provimin me shkrim – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
   2.2. Për provimin me gojë – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
   2.3. Për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:
      2.3.1.Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim para hyrjes në provimin me gojë;
      2.3.2.Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.
3. Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani i njësisë akademike formon komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.
4. Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
5. Në rast të ankesës kundër notës në provimin me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
6. Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.
7. Testet nga provimet lidhur me vlerësimin e studentëve ruhen se paku një (1) vit.

**Neni 115**

1. Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.
2. Sipas rregullës, studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.
3. Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të fortë, mund t’i lejohet nga dekani i njësisë akademike që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund te mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë të emëruar nga dekani i njësisë akademike.
4. Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.
5. Në rast se studenti sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.
6. Studenti mund të ri ftojë statusin e studentit në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve. Vendimi mbi ri fitimin e statusit të studentit përcakton provimet dhe të tjera që i pranohen studentit dhe obligimet e studentit në programin e ri të studimeve.

**Neni 116**

1. Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve bachelor dhe master, studentit do t’i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t’i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
2. Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë.

## Neni 117
## Punimi i diplomës për bachelor dhe master

1. Programet e studimeve bachelor përfundojnë me punimin e diplomës për bachelor ose me provim para komisionit në pajtim me programet e tyre të studimeve.
2. Punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës për bachelor nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.
5. Procedura për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për bachelor përcaktohet këshilli i njësisë akademike.

## Neni 118

1. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
2. Punimi për master punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për master elaborohet nga dy ose tre studentë (grupi kërkimor), dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Aplikimi për elaborimin e punimit të diplomës për master nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.

**5.** Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për master përcaktohet nga këshilli i njësisë akademike.

## Neni 119
## Studimet e doktoratës

1. Studimet e doktoratës propozohen nga njësitë akademike ne fushat e tyre perkatese dhe aprovohen ne Senat.
2. Studimet e doktoratës mund të themelohen dhe të realizohen vetëm në ata lëmenj shkencorë në të cilët institucioni përgjegjës ka kontratë të nënshkruar për marrëdhënie pune të përhershme me më së paku gjysmën e numrit të arsimtarëve dhe nëse në ata lëmenj shkencorë mund t’u përgjigjen kërkesave hulumtuese mësimdhënëse dhe atyre të punës të mentorëve në masë mbi dy të tretat e nevojave.
3. Institucioni përgjegjës që organizon studimet e doktoratës duhet të ketë arritje të pranuara ndërkombëtare në kërkimet shkencore ose artistike, përkatësisht në krijimtarinë artistike.
4. Me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe nxitjes së lëvizshmërisë së doktorantëve dhe të arsimtarëve, studimet e doktoratës janë të hapura për çdo formë të bashkëpunimit me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

**Neni 120**

1. Në kuadër të studimeve të doktoratës formohet Këshilli i studimeve të doktoratës si këshill i përhershëm i Senatit të UP – së.
2. Në kuadër të njësisë akademike – fakultetit që organizon studime të doktoratës formohet këshilli i studimeve të doktoratës si këshill i përhershëm i Këshillit të fakultetit.
3. Përbërja e këshillave të studimeve të doktoratës rregullohet me Rregulloren për studimet e doktoratës të Universitetit.

**Neni 121**

Disertacioni i doktoratës është një punim shkencor i shkruar nga kandidati, i cili shtjellon në mënyrë origjinale dhe unike një apo më shumë tema përkatëse shkencore dhe i cili i nënshtrohet vlerësimit publik shkencor ose artistik.

**Neni 122**

1. Pranimi i studentëve në studimet e doktoratës bëhet nëpërmes konkursit publik të cilin e shpall Universiteti.
2. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë:
   - 2.1. Të diplomuarit me titullin akademik magjistër i shkencës përkatëse.
   - 2.2. Të diplomuarit me titullin akademik master i shkencës dhe master i arteve.
   - 2.3. Te diplomuarit ne studimet themelore (5-6 vjecare) te Mjekesise

3. Kushtet për pranim dhe kriteret për vlerësimin e kandidatëve në studimet e doktoratës i cakton Senati i Universitetit të Prishtinës në pajtim me këtë Statut dhe Rregulloren për studimet e doktoratës.

**Neni 123**

1. Studimet e doktoratës organizohen në gjashtë semestra.
2. Për studentët që kanë mbaruar magjistraturën shkencore, studimet zgjasin dy vjet dhe magjistratura u ekuivalentohet me sistemin e krediteve deri në 1/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të parapara.

**Neni 124**

1. Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoratës, doktoranti propozon mentorin dhe temën.
2. Mentori zgjidhet nga radhët e profesorëve të rregullt dhe profesorëve te asocuar të fushës së njëjtë shkencore, i cili duhet të ketë marrëdhënie të rregullt pune në Universitet. Perjashtimisht me kerkese te keshillit te njesise akademike per mentor mund te angazhohet edhe mesimdhenese me titull akademik profesor asistent nese ka se paku tri punime te botuara ne revista me rencension nderkombetar ne lemine te cilen e udheheq doktorantin. Mund të propozohet edhe një bashkëmentor nga një Universitet tjetër.

3. Doktoranti fillon procedurën e paraqitjes së projekt-propozimit të temës së doktoratës me dorëzimin e fletëparaqitjes, e cila përmban shënimet personale të doktorantit, jetëshkrimin dhe listën e punimeve të doktorantit, titullin e temës së propozuar, të dhënat për mentorin e propozuar dhe kompetencat e tij, arsyeshmërinë e temës dhe pritjet e kontributit shkencor origjinal të hulumtimit të propozuar, vlerësimin e shpenzimeve të hulumtimit, si dhe deklaratën se nuk ka paraqitur punim doktorate me të njëjtën temë në studime të tjera universitare, përkatësisht në ndonjë universitet tjetër. Tema e punimit të doktoratës paraqitet në formular të Universitetit.
4. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, emëron komisionin për vlerësimin e temës dhe propozimin e mentorit në afat prej një muaji nga data e protokollimit të kërkesës së parashtruar. Ky komision përbëhet prej tre anëtarësh, nga të cilët së paku një anëtar nuk duhet të jetë mësimdhënës i studimeve në fjalë e as i punësuar në njësinë akademike e cila është institucion përgjegjës i studimeve. Mentori i propozuar nuk mund të emërohet për kryetar të Komisionit.
5. Komisioni për vlerësimin e temës jep vlerësimin për kontributin shkencor origjinal ose për kontributin artistik origjinal dhe për zbatueshmërinë e kërkimit në pikëpamje financiare dhe organizative, si dhe bën propozimin e mentorit, më së largu një muaj pas paraqitjes së kërkesës.
6. Këshilli i studimeve të doktoratës i njësisë akademike duhet doemos të shqyrtojë propozimin e komisionit për vlerësim të temës dhe propozim të mentorit në semestrin e tretë të studimeve të doktoratës.
7. Projekt – propozimi i punimit të doktoratës mbrohet para Këshillit të studimeve të doktoratës të njësisë akademike, komisionit për vlerësim dhe mentorit të propozuar, 15 ditë pas dorëzimit të raportit të komisionit për vlerësim.
8. Këshilli i njësisë akademike, me propozim të Këshillit të studimeve të doktoratës, ia propozon temën dhe mentorin për miratim Senatit të Universitetit. Senati duhet të vendosë rreth propozimit për disertacion brenda 2 muajve pas kërkesës. Vendimi mund:
   8.1. Të pranojë propozimin origjinal;
   8.2. Të kërkojë nga kandidati që të zgjerojë apo ndryshojë temën;
   8.3. Të kërkojë nga këshilli i njësisë akademike të propozojë tjetër mentor.

**Neni 125**

1. Kandidati për disertacion duhet t'ia dorëzojë Këshillit të njësisë akademike punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda 3 vjetëve nga dita kur është pranuar tema nga Senati i UP – së. Kandidati paraprakisht duhet të siguroj pëlqimin dhe mendimin e mentorit, të shkruar dhe të nënshkruar për hulumtimin e kryer dhe kontributin e arritur shkencor origjinal.
2. Kandidati mund të kërkojë nga këshilli i njësisë akademike që t'i vazhdohet periudha e disertacionit ose e kërkimeve edhe për një vit.
3. Në rast se kandidati nuk e dorëzon punimin e kompletuar të doktoratës për vlerësim brenda periudhës së rregullt ose të vazhduar të disertacionit, konsiderohet se kandidati heq dorë nga tema e caktuar e disertacionit.

**Neni 126**

1. Pasi kandidati ta ketë dorëzuar disertacionin e kompletuar, këshilli i njësisë akademike në propozim të këshillit të studimeve të doktoratës, në afat prej një muaji nga dita e dorëzimit të punimit për vlerësim, duhet të formojë komisionin në përbërje prej 3 anëtarëve për vlerësimin e punimit të doktoratës. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të doktoratës patjetër duhet të kenë së paku titullin akademik profesor asistent.
2. Së paku një anëtar nuk është mësimdhënës në studime të doktoratës, e as i punësuar në fakultet i cili është institucion përgjegjës i studimeve, ndërsa sipas mundësive është i punësuar në ndonjë tjetër universitet të Kosovës apo në ndonjë universitet jashtë Kosovës. Mentori nuk mund të jetë anëtar i komisionit për vlerësimin e punimit.
3. Komisioni është i obliguar të bëjë një vlerësim të plotë të disertacionit brenda 2 muajve, duke përfshirë këtu raportin me shkrim dhe sugjerimin për vlerësim. Raporti i komisionit i drejtohet këshillit të njësisë akademike.
4. Këshilli i njësisë akademike, pas raportit të komisionit, vendos për:
   4.1. Pranimin e disertacionit në versionin e ofruar;
   4.2. Refuzimin e disertacionit për shkak të dështimit;
   4.3. Kthimin prapa të disertacionin për plotësim apo për ndryshim.
5. Në rast se disertacioni kthehet për plotësim apo për ndryshim, këshilli i njësisë akademike cakton periudhën e përshtatshme, që duhet të jetë periudhë prej më së paku 2 muaj dhe më së shumti 6 muaj.
6. Disertacioni i plotësuar apo i ndryshuar duhet t'i dorëzohet këshillit të njësisë akademike bashkë me mendimin e mentorit a mentorëve.
7. Me rastin e miratimit të raportit të komisionit për vlerësim këshilli i njësisë akademike formon komisionin për mbrojtje të doktoratës. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës përbëhet nga tre anëtarë. Komisioni për mbrojtje të punimit të doktoratës mund të jetë në përbërje të njëjtë si komisioni për vlerësimin e punimit të doktoratës.
8. Vendimi i këshillit të njësisë akademike për aprovimin e disertacionit duhet të ratifikohet nga Senati.

**Neni 127**

1. Pasi të jetë konfirmuar nga Senati aprovimi i disertacionit, brenda 2 muajve do të mbahet mbrojtja e disertacionit. Data e saktë caktohet nga dekani i njësisë akademike në pajtim me komisionin për disertacion.
2. Gjatë mbrojtjes publike të disertacionit do të mbahet procesverbali nga sekretari i komisionit i cili caktohet nga dekani i njësisë akademike.

**Neni 128**

1. Pas përfundimit të suksesshëm të mbrojtjes së disertacionit, kandidati fiton titullin akademik Doktor i shkencave (Dr. sc) apo ekuivalente, siç definohet në rregulloret e veçanta të nxjerra nga Senati.
2. Me propozimin e dekanit të njësisë akademike, ku kandidati mbrojti me sukses punimin e disertacionit, rektori i jep gradën shkencore (thirrjen shkencore) në mënyrë ceremoniale.

3. Ceremonia do të jetë publike dhe formale. Procedura e ceremonisë do të përcaktohet me rregulla të veçanta të nxjerrë nga Senati.

**Neni 129**

1. Dokumenti i diplomës së doktorit të shkencës përmban:
   1.1. Emrin e Universitetit;
   1.2. Emrin e njësisë akademike ku është mbrojtur punimi i disertacionit;
   1.3. Emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes së kandidatit;
   1.4. Titullin e punimit të disertacionit;
   1.5. Datën e mbrojtjes së punimit të disertacionit.
2. Dokumenti i diplomës nënshkruhet nga rektori dhe dekani i njësisë akademike ku është mbrojtur me sukses punimi i disertacionit.
3. Dokumenti i diplomës vërtetohet me vulën e Universitetit.
4. Forma dhe elementet tjera të dokumentit të diplomës do të përcaktohen në një rregullore të veçantë të nxjerrë nga Ministria.

**Neni 130**

1. Titulli akademik Doktor shkence mund të revokohet në rast të dëshmisë se:
   1.1. Disertacioni nuk ka qenë punim i vetë kandidatit;
   1.2. Disertacioni nuk ka qenë si rezultat i arritjes personale të kandidatit;
   1.3. Disertacioni është i bazuar në pjesët relevante të rezultateve të mëparshme të botuara shkencore nga individët apo nga institucionet tjera;
   1.4. Është plagjiat apo shkelje e të drejtës së autorit;
   1.5. Është praktikë tjetër joetike.
2. Ankesa për revokim mund t’i parashtrohet këshillit të njësisë akademike nga ana e çdo individi apo institucioni, e mbështetur me të dhëna të hollësishme me shkrim.
3. Pas ankesës, këshilli i njësisë akademike formon një komision 3 anëtarësh nga profesorët e disiplinës së njëjtë shkencore me disertacionin.
4. Anëtarët e komisioneve të disertacionit të ankimuar nuk do të zgjidhen në këtë komision.
5. Komisioni paraqet një raport të vlerësimit në lidhje me arsyeshmërinë e ankesës dhe propozon procedura të mëtutjeshme brenda 2 muajve pasi të ketë filluar procedura.
6. Pas raportit dhe propozimit të komisionit, këshilli i njësisë akademike vendos të refuzojë apo të pranojë ankesën për revokim në mbledhjen e ardhshme.
7. Në rast se këshilli i njësisë akademike e pranon ankesën, Senati do të votojë për këtë vendim në mbledhjen e ardhshme. Doktori i shkencës në fjalë duhet të ftohet që të dëshmojë para Senatit.

**Neni 131**

Universiteti është përgjegjës që të mbajë shënime për titujt e dhënë dhe të revokuar të doktoratës.

**Neni 132**

Lidhur me organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës Senati nxjerr Rregullore.

**Neni 133**
**Titujt akademikë**

Titujt akademik jepen në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Larte.

**Neni 134**

1. Senati me arsye dhe me argumente të forta dhe me rekomandim të rektorit, mund t'ia heqë titullin bartësit.
2. Arsyeja dhe argumenti i fortë përmban:
   2.1. Falsifikimin apo mashtrimin gjatë vlerësimit ose provimit;
   2.2. Plagjiaturën apo shkeljen e të drejtës së autorit në përgatitjen e diplomës apo të punimit tjetër me shkrim;
   2.3. Praktikë tjetër joetike.

**Neni 135**

1. Përfundimi i suksesshëm i studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes diplomës që është dokument zyrtar.
2. Forma, përmbajtja e diplomës, shtojca e diplomës, si dhe procedura e lëshimit do të parashihen me udhezim administrativ të nxjerrur nga Ministria.
3. Diploma nënshkruhet nga rektori dhe dekani i njësisë akademike ku ka përfunduar studimi.

**Neni 136**
**Njohja e studimeve**

1. Në pajtim me rregullat e Konventës së Lisbonës mbi Njohjen dhe në pajtim me rregulloret e veçanta të Ministrisë, Universiteti i pranon kualifikimet (titujt, diplomat, provimet) e institucioneve të njohura a të licencuara vendore ose të huaja të arsimit të lartë.
2. Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT – it mbi parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, është kompetencë e Universitetit që të bëjë njohjen e diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare dhe të certifikatave të periudhave të caktuara të studimeve, me qëllim vazhdimi të studimeve.

3. Në rast se i njihen kualifikimet, studenti ka të drejtë të vazhdojë studimet në Universitet.

**Neni 137**

1. Procedura e njohjes do të drejtohet nga zyrtari profesional i Administratës Qendrore të Universitetit.
2. Vendimi për njohjen e studimeve bazohet në informatat e nxjerra nga baza e të dhënave përkatëse Evropiane dhe koordinohet me Këshillin Kombëtare për Njohje, e cila është përgjegjëse për aplikimin e Konventës së Lisbonës për Njohje.
3. Senati e autorizon rektorin të bëjë njohjen për të gjitha rastet që janë të qarta.

4. Shënimet rreth pranimit të kualifikimit do të mbahen përherë nga Administrata Qendrore e Universitetit.

**Neni 138**

1. Në rastet e diskutueshme, kur të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të marrë vendim, komisionit relevant të studimit duhet t‘i drejtohet lutja për njohje dhe duhet të jepen këto informata:

  1.1. Dosja komplete me të gjitha të dhënat;
  1.2. Të dhënat në dispozicion dhe komentet rreth rastit specifik nga Këshilli Kombëtar për Njohje apo nga institucioni ekuivalent.

2. Komisioni për studime i dorëzon Senatit raportin me propozim për vendim brenda dy muajve prej kur është dorëzuar kërkesa.
3. Vendimi i komisionit mund të jetë si vijon:

  3.1. Njohje e plotë e diplomës nga jashtë;
  3.2. Parashtrimi i listës së provimeve shtesë që kërkohet me qëllim të njohjes së plotë;
  3.3. Refuzimi i kërkesës për shkak të mospërputhjeve kryesore në programet e studimit.

**Neni 139**
**Viti akademik**

1. Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjatë 12 muaj. Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.
2. Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminaret, kolokuiumet) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar. Semestri veror që fillon më 16 shkurt dhe mbaron më 31 maj.
3. Lënda mund të ligjërohet me javë (15 javë semestri) gjatë një apo dy semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një semestër.
4. Kalendari i studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminaret, kolokuiumet), kushtet dhe afatet e provimit.

**Neni 140**

Senati nxjerr rregullore rreth angazhimit dhe ngarkesës të përgjithshëm të studentëve.

**Neni 141**
**Gjuha e studimeve**

1. Universiteti organizon studimet në gjuhën shqipe dhe në gjuhët tjera zyrtare të Kosovës.
2. Me vendimin e Senatit, në propozim të këshillit të njësisë akademike ligjëratat mund të mbahen edhe në gjuhë të tjera.

3. Me propozimin e këshillit të njësisë akademike, Senati mund të vendos nëse programet e studimit do të ofrohen ekskluzivisht në gjuhë të huaj po që se ka argumente përkatëse (promovimi i këmbimit akademik, situata në tregun e punës, interesi i studentëve, orientimi akademik i mësimdhënësve) që i përkrahin këto masa dhe që e favorizojnë zhvillimin akademik të Universitetit.

**Neni 142**
**Ndërrimi i drejtimit të studimeve**

1. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.
2. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti;
3. Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
4. Sipas pikës (3), studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
   4.1. Më së paku në vitin e dytë të studimeve ose;
   4.2. Më së mirë në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.
5. Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë te studimeve në programin e ri të studimeve në pajtim me pikën (3) dhe (4).

**Neni 143**

1. Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të njësisë akademike ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të jetë evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
2. Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.
3. Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e komisionit të studimeve.

4. Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndërrimit të programit të studimit duhet t'i bëhet këshillit të njësisë akademike nga studenti brenda 8 ditëve të punës pas publikimit të vendimit.

**Neni 144**

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin e Prishtinës do të vlejnë rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit.

**Neni 145**
**Studentët – statusi, të drejtat dhe përgjegjësitë**

1. Personi i regjistruar në Universitetin e Prishtinës e ka statusin e studentit.
2. Statusi i studentit vërtetohet me librezën e studentit (indeksi apo karta e studentit).
3. Përmbajtja dhe forma e indeksit përcaktohen me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Senati.

**Neni 146**

1. Universiteti ofron dy mënyra të studimit:
 1.1. studime te rregullta;
 1.2. studime me korrespodencë.
2. Studenti mund te kete statusin e:
2.1. studentit te rregullt;
2.2. studentit me korrespodence;
2.3. studentit mysafir.

**Neni 147**

1. Studentët që janë të pranuar në Universitet kanë të drejtë:
 1.1. të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminaret dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve;
 1.2. të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë:
 1.3.të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet universitare, të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe në mënyrë të sinqertë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të Universitetit.
 1.4. Studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga universiteti;
 1.5. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e universitetit.
 1.6. Studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim të Universitetit ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente.

**Neni 148**

1 . Studentët që janë të pranuar në Universitet kanë obligim:
 1.1. T'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga Universiteti;
 1.2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
 1.3. T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
 1.4. Të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;

1.5. Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Universitetin;

1.6. Te respektojnë rregullat e kodit etik;

1.7. Të paguajnë pagesa dhe tarifa që janë të caktuara.

**Neni 149**

1. Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studenti të regjistrohet në vitin tjetër.
2. Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.
3. Numri maksimal i viteve të regjistruara sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës.

**Neni 150**

1. Studenti i rregullt humb statusin për këto arsye:

1.1. Kur vendos të largohet nga studimet;

1.2. Kur i ka përfunduar studimet;

1.3. Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;

1.4. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;

1.5. Kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet.

1.6. Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerr pas procedurës disiplinore.

2. Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr këshilli i njësisë akademike. Në rast se merret vendim pozitiv studenti do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.
3. Këshilli i njësisë akademike zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste:

3.1. Për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lart;

3.2. Për të arriturat e veçanta si krijues artistik i njohur, vërtetuar me reagimin relevant të mediave dhe konfirmuar nga Këshilli i Fakultetit të Arteve;

3.3. Për individët me aftësi të kufizuar fizike, duke përfshirë edhe aftësitë e kufizuara të të paritë dhe të dëgjuarit, apo mendore, vërtetuar me certifikatë të mjekut.

4. Vendimi për regjistrim merret për çdo vit nga këshilli i njësisë akademike.

5. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:

5.1. Sëmundjes së rëndë;

5.2. Kujdesi për fëmijët nën moshën tri vjeçare;

5.3. Shtatzënësisë dhe lehonisë;

6. Tjera të justifikuara. Vendimin përfundimtar e merr dekani i njësisë akademike.

**Neni 151**

1. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studenti duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.
2. Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te dekani i njësisë akademike për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit.

**Neni 152**

1. Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
2. Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve.

**Neni 153**

1. Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga komisioni disiplinor i cili e këshillon këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Komisionit të ankesave në nivel të njësisë akademike si shkallë e dytë.
2. Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Këshilli drejtues pasi të jenë konsultuar me parlamentin e studentëve.

**Neni 154**

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësive akademike dhe njësive organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
2. Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

3. Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
4. Ankesa rreth vendimit në shkallë të dytë vendoset nga Senati.
5. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.

**Neni 155**
**Mobiliteti i studentëve**

1. Në pajtim me programin e studimeve studenti mund të zgjedhë dhe të regjistroj lëndë të caktuar në njësitë tjera akademike të universitetit në qoftë se lënda e zgjedhur nuk zhvillohet në fakultetin ku është i regjistruar studenti.
2. Regjistrimi i lëndës mund të bëhet me lejen e njësisë akademike ku është i regjistruar studenti dhe me pajtimin e njësisë akademike ku studenti e regjistron lëndën.
3. Me rastin e lejimit studentit i jepet vërtetimi mbi lejimin për regjistrim të lëndës së caktuar dhe lartësia e ECTS kredive që do të fitohen me përfundimin e lëndës. ECTS kreditë e fituara do ti llogariten në programin e studimeve të studentit.
4. Ne dokumentin zyrtar të studentit shënohen të dhënat për lëndën e regjistruar, përmbushja e obligimeve të studentit dhe suksesi i treguar. Për ECTS kreditë e fituara studentit i lëshohet dëshmi nga njësia akademike ku studenti i ka fituar ato.
5. Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve dhe në mes të universiteteve në Kosovë rregullohet me akt të veçantë të Universitetit. Me këtë akt dhe me marrëveshje me universitetin prej nga vjen studenti mysafir do të rregullohen edhe të drejtat dhe obligimet e studentëve mysafir, pagesat për studime dhe çështje tjera lidhur me studentin mysafir.

**Neni 156**
**Organizimi i studentëve**

1. Studentet kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t’i përkasin të gjithë studentët.
2. Secila organizatë studentore ka statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregulloret e përgjithshme të nxjerra nga Këshilli Drejtues. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.

**Neni 157**

1. Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të Universitetit me këto organe:
    1.1. Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit;
    1.2. Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike.

**Neni 158**

1. Anëtarët për Parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjidhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.
2. Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillin e studentëve të njësive akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
3. Detajet për procedurën zgjedhore do të përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga Këshilli Drejtues ne Konsultim me Parlamentin e Studenteve.
4. Limiti për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:
    4.1. 3% i numrit të përgjithshëm të votave në nivel të njësisë përkatëse akademike për këshillat e studentëve të njësive akademike.

4.2. 5% i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e studentëve.
5. Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe këshillit të studentëve të njësive akademike zgjat 2 vjet, pa te drejte te rizgjedhjes.
6. Parlamenti i studentëve dhe këshillat e studentëve të njësive akademike ushtrojnë detyra në bazë të parimit të shumicës votave.

**Neni 159**

1. Parlamenti i studentëve është organi suprem i përfaqësimit të studentëve.
2. Numri i tërësishëm i anëtarëve të parlamentit të studentëve është 17.
3. Anëtarët propozohen nga organizatat studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore ne fillim të fushatës zgjedhore.
4. Anëtarët e Parlamentit të studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin.
5. Këshilli Drejtues nxjerr rregulloren e punës për parlamentin e studentëve.
6. Parlamenti i studentëve zgjedh anëtarët e Senatit nga lista e të propozuarve e përgatitur nga këshilli i studentëve i njësisë akademike. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar exofficio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit.

**Neni 160**

1. Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.
2. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është 1% i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë njësi akademike, me më së paku 5 dhe më së shumti 21 anëtarë.
3. Anëtarët do të propozohen nga organizata studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritur gjatë zgjedhjeve të studentëve për secilën njësi akademike sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga organizata studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
4. Anëtarët e secilit këshill të studentëve zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar.
5. Këshilli Drejtues nxjerr rregulloren e punës për këshillat e studentëve.
6. Secili këshill i studentëve propozon listën me tre kandidatë për anëtarë studentë të Senatit për tu zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.
7. Këshilli i studentëve i secilës njësi akademike zgjedh anëtarët studentë të këshillit të njësisë akademike. Kryetari i këshillit të studentëve është anëtar exofficio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve student të këshillit të fakultetit.

**Neni 161**

Këshilli drejtues i ndan një buxhet të përshtatshëm vjetor për veprimtarinë e Parlamentit të studentëve dhe këshillave të studentëve te propozuar nga Parlamenti i Studenteve.

**Neni 162**

Studentët kanë të drejtë për tubime paqësore.

**Neni 163**

Studentët kanë të drejtë të formojnë asociacione profesionale apo shoqata për çfarëdo qëllimi të lejuar me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

**Neni 164**
**Kërkimet shkencore dhe dija**

1. Universiteti bën kërkime shkencore dhe punë artistike me qëllime të:
    1.1. zhvillimit të vazhdueshëm të procesit arsimor;
    1.2. njohjes së studentëve me kërkimet shkencore dhe me punën artistike;
    1.3. vazhdimit të zhvillimit shkencor - profesional dhe artistik të rinjve;
    1.4. themelimit të rrjetit ndërkombëtar të studiuesve dhe artistëve;
    1.5.përgatitjes dhe paraqitjes së projekteve studimore dhe artistike ndërdisiplinare konkurruese.
2. Kërkimet shkencore bëhen nga njësitë akademike të Universitetit në dy mënyra:
    2.1. Nga kërkimet themelore pa përdorim të menjëhershëm praktik;
    2.2. Nga kërkimet e aplikuara që janë në lidhje të ngushtë me nevojat dhe interesin publik.
3. Kërkimet shkencore dhe krijimtaria artistike bëhen sipas këtyre kushteve themelore:
    3.1. përmes fondeve publike të siguruara nga Universiteti;
    3.2. përmes fondeve private nga kontraktorët individualë me palën e tretë.
    3.3. permes konkurimit ne projekte nderkombetare.

**Neni 165**

1. Universiteti është i obliguar t’u ofrojë kushte të përshtatshme për kërkime shkencore dhe për krijimtari artistike dhe t’i mundësojë personelit akademik të arrijë rezultate konkurruese në nivel ndërkombëtar.
2. Personeli i stafit akademik i Universitetit është i obliguar të bëjë kërkime shkencore dhe punë krijuese në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga udhëzimet strategjike të Senatit si dhe të këshillave të njësive përkatëse akademike.
3. Vlerësimi individual i punës artistike dhe kërkimit shkencor do të merret parasysh në vlerësimin profesional dhe në ngritjen profesionale.

**Neni 166**

1. Kërkimet shkencore dhe krijimtaria artistike bëhen brenda objekteve të Universitetit.
2. Me propozimin e këshillit të njësisë akademike rektori mund t’i japë leje personelit akademik të kryej kërkime dhe punë krijuese në lokacionet e caktuara jashtë Universitetit dhe të marrë pjesë në projektet e përbashkëta me institucionet tjera.

**Neni 167**

1. Shtrirja dhe rezultatet e aktiviteteve kërkimore - shkencore dhe të punës krijuese do të raportohen individualisht për çdo vit nga një punonjës akademik para këshillit të njësisë akademike.
2. Çdo njësi akademike duhet të paraqesë për çdo vit profilin e kërkimit shkencor dhe të punës artistike para rektorit dhe Senatit.
3. Të gjitha të dhënat sa i përket kërkimeve shkencore dhe punës artistike, siç është e caktuar në këtë Statut, duhet të mblidhen si shënime statistikore të standardizuara dhe duhet të ruhen në një bazë qendrore të dhënave, të mundësuar nga Rektorati.

**Neni 168**

1. Profesorët e universitetit kanë të drejtë të kërkojnë nga Senati që t'u lejohet një vit i lirë i kërkimeve të fokusuara në një universitet të huaj.
2. Vendimi pozitiv i kërkimeve të fokusuara për një vit kërkon:
    2.1. Paraqitje për projektin kërkimor;
    2.2. Së paku 5 vjet angazhim të plotë në mësimdhënie dhe kërkime;
    2.3. Kompetencë të dëshmuar shkencore dhe njohje brenda komunitetit shkencor ndërkombëtar;
    2.4. Ftesë për kërkime shkencore nga një institut apo universitet i huaj.
3. Gjatë vitit te liruar, i punësuari do të marrë pagën e plotë.
4. Pas vitit të kërkimeve të fokusuara i punësuari ka të drejtë të kthehet në pozitën e njëjtë të punës me kushte të njëjta si më parë.

**Neni 169**
**Punonjësit e Universitetit**
**Stafi akademik dhe joakademik**

1. Të gjitha vendet e punës do të bazohen në kontratat me normë të plotë dhe kontratat me gjysmë normë.
2. Këshilli drejtues nxjerr rregullore të veçanta për kontratat kolektive për personelin akademik dhe joakadamik në përputhje me ligjet në fuqi.

**Neni 170**

1.Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë ne ndonjë universitet tjeter.
2. Personeli ne marredhenie te rregullt pune, i cili mund te jete i angazhuar, zgjedhur apo emeruar ne ndonje institucion tjeter publik nuk ka te drejte per t'u zgjedhur ne organe drejtuese, por ka te drejte per te zgjedhur.

**Neni 171**

1. Në stafin akademik të Universitetit do të jenë personat e angazhuar në:
    1.1. mësimdhënie akademike;

1.2. kërkime shkencore;
1.3. krijimtari artistike.

2. Personeli akademik përbëhet nga:
   2.1. Profesorët e rregullt;
   2.2. Profesorët e asocuar;
   2.3. Profesorët asistentë;
   2.4. Asistent universiteti;
   2.5. Lektorët dhe Korepetitoret (Fakulteti i Arteve)
3. Shkurtesat zyrtare për personelin akademik janë:
   3.1. Profesor i rregullt – Prof. Dr.
   3.2. Profesor i asocuar – Prof. Asoc. Dr.
   3.3. Profesor asistent – Prof. Ass. Dr.
   3.4. Asistent universiteti – Ass.

**Neni 172**

1. Në personelin joakademik të Universitetit do të jenë personat që angazhohen për:
   1.1. Detyra udhëheqëse dhe profesionale;
   1.2. Administratë;
   1.3. Punë teknike.
2. Përgjegjësitë dhe kualifikimet e veçanta për çdo post do të përcaktohen me përshkrimin e punës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 173**

1. Personeli akademik do të emërohet nga rektori sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike.
2. Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike.
3. Nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjellë të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar.
4. Procedurat për emërim do të bëhen në mënyrë transparente me shpalljen e konkursit publik për postin.
5. Te gjitha emërimet bëhen pasi t’i shqyrtojë dokumentacionin e aplikimit komisioni vlerësues i formuar nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e degës – departamentit. Komisioni vlerësues bënë vlerësimin e kandidateve të cilët konsiderohen që kanë përmbushur kushtet për postin e ofruar.
6. Komisioni vlerësues i raporton këshillit që e ka formuar, në afat të caktuar.

7. Askush nuk mund të jetë anëtarë i komisionit vlerësues nëse është bashkëshort, partner ose anëtarë i familjes së ngushtë të kandidatit që duhet të emërohet.
8. Çështje tjera për procedurat vlerësuese përcaktohen me rregullat e nxjerra nga Senati në pajtim me këtë Statut.

**Neni 174**

Kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës.

## Neni 175

1. Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike kandidati duhet të ketë këto kualifikime:

1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës (ekuivalente më të në Fakultetin e Arteve);

1.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:

1.2.1. një numër të rëndësishëm të monografive, teksteve mësimore, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me më së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ose artistike ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespodent;

1.2.2. pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare;

1.2.3. Krijime a punime te njohura artistike ose të ketë pasur prezantime publike dhe të ketë kontribuar kur është rasti i Fakultetit të Arteve; në mënyrë të veçantë duhet të ketë kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe të artit;

1.2.4. përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme;

1.2.5 aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;

1.2.6. aftësi për udhëheqje akademike;

1.2.7. udhëheqje të temave master dhe të doktoratës.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen për kohë të pacaktuar.

## Neni 176

1. Për titullin e profesorit të asocuar kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës (ekuivalente më të në Fakultetin e Arteve);

1.2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespodent;

1.3. Të ketë krijuar punime të vërteta artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është rasti për Fakultetin e Arteve;

1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;

1.5. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtri në lëndën e lëmit përkatës.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

## Neni 177

1. Për titullin e profesorit asistent kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të ketë gradën e doktorit te shkencës, (Në fakultetin e Arteve ekuivalente me te);

1.2. Të ketë numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare, si autor i pare ose korrespodent;

1.3. Të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezantime publike, kur është fjala për Fakultetin e Arteve;

1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie.

1.5. Të ketë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Arsimin e larte.

1.6. Kandidati i cili zgjidhet per here te pare, nuk duhet te jete me i vjeter se 50 vjet.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

**Neni 178**

1. Për titullin e asistentit te universitetit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet Master në drejtimin përkatës, përkatësisht për Fakultetin e Mjekësisë të ketë të përfunduar Fakultetin e mjekësisë (në rastin e lëndëve klinike të ketë të përfunduar specializimin apo te jete te pakten ne vitin e trete te specializimit ne rastin e rizgjedhjes).

1.2. Të jetë jo me i vjetër se 30 vjet (respektivisht 35 vjet në Fakultetin e Mjekësisë) kur emërohet për herë të parë. Perjashtimisht kandidati mund te zgjedhet asistent universiteti deri ne moshen 40 vjeçare nëse ka gradën e doktorit te shkences.

1.3. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes;

1.4. Te ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo me pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

2. Të gjitha emërimet si dhe kohëzgjatja e punësimit zgjat 3 vite.

3. Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master. Përjashtimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën, mund te autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimdhënësi nga departamenti - katedra.

**Neni 179**

1. Për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;

1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;

1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

2. Lektorët në fakultetet e tjera pos në fakultetin amë i kanë të gjitha të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave.

3. Për titullin e Korepetitorit kandidati duhet ti plotesoje keto kushte:

3.1. Te ketë te përfunduar me sukses studimet Master, drejtimi i pianos

3.2. Te ketë note mesatare jo me pak se 8, ne secilen prej ketyre studimeve

4. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për 3 vite.

## Neni 180

1. Rregulloret shtesë rreth kualifikimit të posaçëm të personelit akademik të fakultetit përkatës do të nxirren nga Senati me propozimin e këshillit përkatës të njësisë akademike dhe në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.
2. Senati nxjerre Rregullore te veçante per ekuivalentimin e personelit akademik te Fakultetit te Arteve, me propozim te Keshillit Te Fakultetit te Arteve, ne pajtim me dispozitat e këtij Statuti, brenda 6 muajve pas hyrjes ne fuqi te këtij Statuti.

## Neni 181

1. Profesorit të pensionuar të njësisë akademike mund t'i caktohet titulli 'Profesor Emeritus' nga Senati me propozimin e këshillit të fakultetit përkatës dhe me përkrahjen e së paku dy këshillave të njësive akademike.
2. Kandidati për titullin "Profesor Emeritus" dallohet nga arritjet e veçanta akademike dhe shkencore gjatë periudhës së aktivitetit të tij. Kualifikimet e tij konsiderohen të pa zëvendësueshme për një periudhë afatmesme nga ana e njësisë akademike. Kjo nevojë duhet të detajizohet nga komisioni i studimeve i njësisë akademike.
3. "Profesori Emeritus" do të ketë të drejtën të jap mësim dhe të merret me punë shkencore në pajtim me kualifikimet e tij dhe kërkesave të njësisë së veçantë akademike deri në moshën 70 vjeçare.
4. Çështjet tjera rreth të drejtave dhe përgjegjësive të "Profesorit Emeritus" caktohen me kontratë individuale të lidhur nga rektori me propozimin e dekanit të njësisë së veçantë akademike.

## Neni 182

Këshilli drejtues me propozimin e Senatit do të nxjerrë rregulloret e kodit etik të punonjësve të Universitetit.

## Neni 183

1. Përgjegjësitë disiplinore të punësuarve në Universitet dhe masat që duhet të ndërmerren përcaktohen me rregulloret e nxjerra nga Këshilli drejtues.
2. Procedurat dhe kushtet për revokimin e titujve, suspendimin apo ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të stafit përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga Këshilli drejtues pasi të jetë konsultuar me Senatin.

## Neni 184
## Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit

1. Personeli akademik ka lirinë e shprehjes. Ata kanë lirinë të pyesin dhe testojnë njohuritë e marra dhe të shprehin idetë e reja, mendimet kundërshtuese pa e vënë veten në rrezik me humbjen e punës apo çfarëdo privilegji që mund të kenë me Universitetin.
2. Personeli akademik ka lirinë për të publikuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe krijuese, që kushtëzohet me rregulloret e këtij Statuti që ka të bëjë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale për dobi të Universitetit.

3. Personeli akademik qe tregon rezultate te shkelqyeshme ne pune hulumtuese dhe e dokumenton me publikime shkencore, me se paku 2 publikime ne revista prestigjioze nderkombetare me impakt faktor ne vitin paraprak, mund te lirohet per 1/3 e normes se mesimdhenies ne vitin vijues.

**Neni 185**

1. Personeli akademik i Universitetit është i obliguar të respektojë:
    1.1. Frymën e humanizmit;
    1.2. Autonominë e Universitetit;
    1.3. Lirinë e kreativitetit shkencor dhe artistik;
    1.4. Aktet universitare dhe vendimet e bazuara në to;
    1.5. Parimet e ndershmërisë profesionale dhe shkencore;
    1.6. Kodin etik;
    1.7. Reputacionin e universitetit dhe ta përmirësoj atë.

**Neni 186**

1. Personeli akademik i Universitetit gjatë procesit arsimor është i obliguar t'i përmbush këto detyra:
    1.1. Të përgatis dhe ofrojë mësimet, seminaret, ushtrimet dhe format e tjera të ligjëratës;
    1.2. Të përgatis tekstet universitare ose literaturën e përshtatshme për studime brenda strukturës së lëndës;
    1.3. Të mbikëqyrë punimet seminarike, punimet e diplomës për bachelor dhe master, punimet e disertacionit të doktoratës dhe punët tjera kërkimore të studentëve;
    1.4. Të sigurojë mbajtjen pa pengesë të provimeve gjatë afatit të caktuar të provimeve.

**Neni 187**

1. Personeli duhet të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me përkushtim dhe sinqeritet.
2. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të punëtorëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të Universitetit.

**Neni 188**

Personeli ka të drejtën e tubimit paqësor dhe të drejtën e formimit të sindikatës, të bashkimit të stafit apo bashkimit profesional për t'i përfaqësuar interesat e tyre kolektive para autoriteteve të Universitetit dhe për qëllime të tjera të parapara me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

**Neni 189**

1. Personeli akademik dhe joakademik kanë të drejtë te paraqesin ankese ndaj vendimeve te marra nga organet e Universitetit, nga njësite akademike apo nga njësitë organizative rreth të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësive të tyre.

2. Ankesat e tilla duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve të punës pasi të jetë publikuar vendimi relevant.
3. Ankesa ndaj vendimit, nëse nuk caktohet ndryshe në këtë Statut, duhet të vendoset në radhë të parë nga:

3.1. Këshilli i njësisë akademike, nëse vendimi në shkallë të parë është bërë nga dekani;

3.2. Këshilli Administrativ i njësisë organizative, nëse vendimi në instance të parë është bërë nga drejtori;

3.3. Rektori, nëse vendimi në instancë të parë është bërë nga prorektori apo nga sekretari i përgjithshëm;

3.4. Senati, nëse vendimi në instancë të parë është bërë nga këshilli i njësisë akademike apo këshilli administrativ i njësisë organizative;

4. Këshilli drejtues, nëse vendimi në instancë të parë është bërë nga rektori apo senati;
5. Ministria, nëse vendimi në instancë të parë është bërë nga Këshilli drejtues.

**Neni 190**
**Titujt e nderit, çmimet dhe mirënjohjet e Universitetit**

1. Universiteti u ndanë titujt e nderit personave të merituar.
2. Senati do të nxjerrë rregullore të veçantë për procedurën e vendimmarrjes në përzgjedhjen e titujve të nderit, çmimet për student te dalluar dhe mirenjohjet.

**Neni 191**

1. Titulli Doktor Nderi (“Dr. honoris causa”) jepet për:

1.1. Arritje të mëdha në fushën e shkencës dhe artit;

1.2. Kontributet e rëndësishme në zhvillimin e marrëdhënieve njerëzore në mbështetjen dhe konsolidimin e paqes.

**Neni 192**

1. Titulli “Anëtar Nderi i Universitetit” jepet për:

1.1. Përkrahje të pandërprerë të brendshme dhe për përkrahjen politike për Universitetin;

1.2. Kontribut relevant financiar në zhvillimin e Universitetit.

**Neni 193**
**Procedurat e menaxhimit, kontrolli i cilësisë dhe administrimi**
**Menaxhimi financiar dhe kontrolli**

Ministria e Financave ka obligim të sigurojë financimin e duhur për Universitetin për të përmbushur obligimet dhe përgjegjësitë e saj që dalin me dispozitat e këtij Statuti.

**Neni 194**

1. Universiteti në përputhje me dispozitat e këtij Statuti ka të drejtë të marr fonde nga këto burime:

1.1. Alokimet nga Ministria e Financave, për mësim, kërkime shkencore dhe punë artistike me interes të përgjithshëm në bazë të buxhetit të aprovuar;

1.2. Tarifat për shkollim dhe pagesat tjera të paguara nga studentët;

1.3. Pagesat për shërbime komerciale dhe shërbimet tjera;

1.4. Donacionet, dhuratat dhe ndihmat;

1.5. Kontratat me organet vendore, ndërkombëtare, publike dhe private për mësimdhënie, kërkime shkencore, punë artistike dhe konsulta.

**Neni 195**

1. Universiteti është i lirë që të lidh kontratë për çfarëdo qëllimi që ka të bëjë me arsimin e lartë, me kërkimet shkencore apo punën artistike. Universiteti mund të investojë fonde përveç atyre publike në çdo ndërmarrje që ka qëllime arsimore, kërkimore - shkencore apo qëllime artistike nëse:

1.1. Kontratat që imponojnë detyrime ndaj pronës së aseteve publike janë në përputhje me ligjin në fuqi dhe kanë pëlqimin e MASHT dhe MF;

1.2. Nuk vihen në rrezik fondet publike.

**Neni 196**

Nëse Universiteti nuk e fiton riakreditimin per ndonje program, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ministria mundet që përmes aktit nënligjor të marrë masa të përkohshme për financimin e tij dhe marrjen e pagesave të shkollimit dhe të hyrave të tjera deri në rimarrjen e akreditimit, mbylljen apo shkrirjen, siç parashihet me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës.

**Neni 197**

1. Fondet alokohen nga Ministria e Financave  në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin e buxhetit gjatë vitit financiar,sipas kërkesës buxhetore  të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.
2.  Fondet e alokuara nga Ministria e Financave për Universitetin depozitohen ne kodin buxhetor të UP-së, për t'u administruar nga rektori në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. Nënllogaritë do të formohen për çdo njësi akademike dhe organizative në dispozicion dhe në përgjegjësi të dekanit apo drejtorit të tij.

**Neni 198**

Brenda kufijve buxhetor të aprovuar nga Buxheti i Kosovës, Këshilli drejtues ka të drejtë të bëjë transferin e kufizuar të buxhetit në mes linjave buxhetore maksimum 10% për vit, si dhe të bëjë ndryshimin e fondeve të alokuara sipas kategorive ekonomike.

**Neni 199**

1. Alokimi i buxhetit nga Ministria e Financave do të ketë parasysh rezultatet e vlerësimit dhe raportet e punës të siguruara nga Universiteti si dhe vërejtjet dhe rekomandimet e siguruara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.
2. Alokimi i buxhetit nga Ministria e Financave nuk do të ketë parasysh asnjë nga fondet private të paraqitura nga Universiteti apo nga njësitë e tij akademike organizative.

**Neni 200**

1. Të gjithë njësitë akademike janë të obliguara të përgatisin raportin vjetor të buxhetit dhe të dorëzojnë brenda afatit ligjor në administratën qendrore të UP-së.
2. Buxheti i shpenzuar do të raportohet më së voni deri më 31 janar të vitit tjetër në vijim.
3. Raportet buxhetore do të përgatiten në bazë të standardeve të specifikuara nga Ministria e Financave-Thesari.
4. Departamenti i buxhetit dhe financave i Universitetit do të përgatisë raportin vjetor mbi shpenzimin e buxhetit në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 201**
**Procedurat buxhetore**

Rektori i UP-së, ka për detyrë të përgatisë planin vjetor të hyrave dhe shpenzimeve për shqyrtim nga ana e Këshillit drejtues, si dhe raportin e menaxhimit të buxhetit dhe burimeve të aprovuar nga Ministria e Financave sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Neni 202**

Këshilli drejtues do të nxjerrë planin vjetor financiar të bazuar në procedurat buxhetore në përputhje me këtë Statut dhe ligjet në fuqi.

**Neni 203**

1. Procedurat buxhetore përmbajnë këto veprime:

1.1. Elaborimin e raportit të zhvillimit të hyrave dhe të shpenzimeve vjetore do ta bëjë Departamenti i buxhetit dhe financave në bashkëpunim me dekanët,drejtorët e instituteve dhe njësive organizative për: Rektorin, këshillin drejtues dhe ministrinë e financave.

1.2. Përgatitjen për kërkesat fillestare buxhetore do ta bëjnë Departamenti i buxhetit dhe financave në bashkëpunim me dekanët dhe njësitë organizative.

1.3. Dëgjimet buxhetore rreth kërkesave me njësitë akademike dhe organizative do të organizohen nga Rektori dhe Drejtori i buxhetit dhe financave të UP-së.

1.4. Raporti i vjetor i shpenzimeve te buxhetit do te paraqitet ne mënyre gjithë përfshirëse me te dhënat e buxhetit te aprovuar dhe shpenzuar sipas kategorive ekonomike.

1.5. Të dhënat për përmbushjen e detyrave dhe veprimtarisë bazohen në dispozitat për raportimin e veprimtarisë dhe përmbushjes së detyrave me këtë Statut.

**Neni 204**

1. Buxheti i aprovuar për çdo njësi akademike dhe organizative paraqet gjendjen aktuale të financave për vitin aktual buxhetor dhe përbehet nga kategoritë ekonomike qe përcaktohen me ligjet ne fuqi dhe dispozitat e këtij statuti .
2. Kërkesat për investime kapitale apo projekte të tjera paraqiten ne mënyre te specifikuar dhe arsyetuar duke u bazuar ne planin strategjik te zhvillimit te UP-

**Neni 205**

Të dhënat për procesin buxhetor ruhen në bazën e të dhënave ne Administratën qendrore dhe njësit akademike dhe organizative.

**Neni 206**
**Pagesat e studentëve**

1. Pagesat e studentëve bëhen për shërbime specifike të ofruara nga Universiteti në kohën e programit të studimeve.
2. Pagesat vjetore të studentëve janë gjithëpërfshirëse në pajtim me rregulloret e veçanta të Ministrisë dhe përbëjnë të gjitha shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës së rregullt të studimeve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
3. Pagesat e studentëve vlejnë për studimet themelore – bachelor, studimet master dhe studimet e doktoratës.
4. Këshilli drejtues nxjerr rregullore të detajizuar për llojin dhe shumën e pagesës së studentëve që do të jetë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria.

**Neni 207**

1. Pagesat e studentëve do të derdhën në llogarinë e i Universitetit.
2. Gjatë procedurave buxhetore vjetore një përqindje përkatëse e pagesave të studentëve i kthehet njësisë akademike prej ku janë marrë për zhvillimin e shërbimeve arsimore, në përputhje me këtë Statut.
3. Këshilli drejtues vendos që kjo përqindje e caktuar të ndahet drejt dhe në mënyrë transparente.
4. Pjesa e mbetur e pagesave të studentëve mbahet si buxhet rezervë. Kjo shumë caktohet për zhvillimin e programeve të veçanta të studimit, per financim te mobilitetit te studenteve per qellime shkencore afat-shkurtera dhe ndahet nga Këshilli drejtues.

**Neni 208**
**Kontrolli financiar**

1. Në pajtim me Ligjet në fuqi Universiteti i nënshtrohet, në baza vjetore, një auditimi të jashtëm të rregullsisë dhe të kontrollit financiar nga autoriteti i përcaktuar me Ligj.
2. Autoriteti i përcaktuar me Ligj i dorëzon universitetit një raport mbi auditimin e rregullsisë. Përgjigjet e dhëna nga Universiteti, nëse ka të tilla, lidhur me raportin i bashkëngjiten raportit dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Pas publikimit të raportit, Autoritetet qeverisëse dhe menaxheriale të Universitetit i dorëzojnë Autoritetit të përcaktuar me Ligj një raport i cili përcakton masat të cilat ka për qëllim ti ndërmarr për zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportin e auditimit të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

**Neni 209**

1. Me qëllim të vendosjes të një efikasiteti më të madh operacional, një disipline më të madhe buxhetore dhe fiskale si dhe respektimin e rregullave lidhur me shfrytëzimin e drejtë të mjeteve, UP në pajtim me Ligjet në fuqi krijon funksionin e auditimit të brendshëm.
2. Auditimi i brendshëm është aktivitet i pavarur këshillëdhënës që ndihmon universitetin në përmbushjen e objektivave të saj, duke ofruar qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.
3. Autoritetet e universitetit do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë e auditorit të brendshëm.
4. Auditori i brendshëm do ti ushtroj aktivitetet e veta në pajtim me Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
5. Këshilli drejtues, rektori, sekretari i përgjithshëm dhe auditorët, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, kanë të drejta të pakufizuara për qasje në të gjitha të dhënat dhe dokumentet zyrtare të Universitetit dhe personelit të tij.

**Neni 210**
**Kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi**

Universiteti zhvillon sistemin e vet të sigurimit të cilësisë me qëllim të ruajtjes së cilësisë dhe të arritjes së objektivave të veprimtarisë.

**Neni 211**
**Sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi**

1. Vlerësimit i nënshtrohen të gjithë dhe ky vlerësim përfshin gjithë spektrin e Universitetit dhe shërbimet e tij.
2. Vlerësimet analizojnë efikasitetin dhe efektshmërinë e funksionimit të Universitetit në të gjitha fushat e veprimit. Ai u siguron njësive të vlerësuara dhe organeve përgjegjëse të qeverisjes treguesit për masat e sigurimit dhe përmirësimin e cilësisë, si dhe me vendimet që kanë të bëjnë me personelin dhe organizimin.

**Neni 212**

Vlerësimet udhëhiqen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit.

**Neni 213**

1. Vlerësimet kanë këto efekte;

1.1. Motivimin dhe vlerësimin publik në rast të rezultateve pozitive;

1.2. Zbatimin e masave të përshtatshme me qëllim të përmirësimit të punës në rast të rezultateve negative.

**Neni 214**

Rezultatet dhe efektet nga vlerësimi do të merren parasysh nga organet e qeverisjes së Universitetit dhe të njësive të saj dhe ato do të kenë ndikim në alokimin e buxhetit.

**Neni 215**

1. Vlerësimet e parapara:

1.1. Vlerësimi i masave të menaxhimit në të gjitha nivelet organizative në lidhje me:

1.1.1 themelimin dhe përshtatjen e programeve të studimit;

1.1.2. ndërrimin e programeve të studimit;

1.1.3 masat organizative si themelimi, përshtatja dhe shkrirja e njësive institucionale;

1.1.4 arritja e qëllimeve sociale;

1.2. Vlerësimi i programeve të studimit dhe organizimit të studimeve;

1.3. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies;

1.4. Vlerësimi i aktiviteteve kërkimore;

1.5. Vlerësimi i punës artistike.

2. Vlerësimet bëhen për t'i arritur objektivat, përshtatjen e punës dhe ekonomizimin e masave të marra.

**Neni 216**

1. Vlerësimi i punës së mësimdhënësve, i kërkimeve shkencore dhe i punës artistike bëhet në këtë mënyrë:

1.1. Vlerësimet e brendshme përmes vlerësimit vetanak;

1.2 pyetësorët dhe vetëvlerësimi nga ana e personelit akademik;

1.3 pyetësorët anonim të vlerësimit nga studentët;

1.4 analiza e parametrave në bazë të raportit të punës dhe përmbushjes së detyrave;

2. Vlerësimet e jashtme nga kolegët ndërkombëtarë:

2.1. prezenca në orë;

2.2. raportet e ekspertëve.

3. Universiteti bën rregullisht vlerësimet e jashtme në pajtim me këtë Statut dhe standardet e përcaktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

4. Senati nxjerr rregulloret rreth orarit, rreth procedurave dhe masave të gjitha llojeve të vlerësimit në pajtim me këtë Statut dhe pasi të jetë konsultuar me Këshillin drejtues.

**Neni 217**

1. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve bëhet një herë në vit përmes pyetësorëve anonim që koordinohen nga komisioni i posaçëm i studimeve.
2. Pyetësorët përpilohen detajisht nga komisioni i studimeve të secilës njësi akademike duke u bazuar në strukturën standarde të pyetësorëve të dhënë nga Senati dhe do të ruhen e do të shfrytëzohen në mënyrë kompjuterike.
3. 10% e rezultateve më të mira vjetore të vlerësimit të cilësisë së mësimit do të publikohen nga ana e çdo udhëheqësi të komisionit për studime.
4. Udhëheqësi i çdo komisioni për studime është i obliguar që t'i diskutojë me mësimdhënësit të radhitur në 10% të rezultateve më të ulëta vjetore nga ana e studentëve dhe të vendosin bashkërisht rreth masave që duhet ndërmarrë për përmirësimin e cilësisë së mësimit.

**Neni 218**

1. Të gjitha vlerësimet e jashtme dhe të brendshme do të kryhen me procedurë standarde, duke përfshirë veprimet në vijim:

1.1. Autoritetet drejtuese që janë përgjegjëse për vlerësim para se të bëhet vlerësimi e informojnë njësinë e Universitetit të prekur nga ky vlerësim për:

1.1.1. fushat;

1.1.2. objektivat;

1.2.3. procedurat dhe oraret;

1.2.4. instrumentet.

1.2. Përgatitjen e versionit të raportit me shkrim pas përfundimit të vlerësimit për:

1.2.1. procedurën e vlerësimit;

1.2.2. rezultatet;

1.2.3. masat e propozuara.

1.3. Njësive të vlerësuara u jepet një periudhë e arsyeshme kohore për të reaguar për versionin e raportin. Këto komente do të bëhen pjesë integrale e raportit të vlerësimit.

1.4. Raporti final i vlerësimit do t'u jepet:

1.4.1. të gjithë personave përgjegjës të njësive të vlerësuara;

1.4.2. autoriteteve drejtuese që janë përgjegjës për zbatimin e këtyre masave.

1.5. Rektori kërkon zbatimin e raportit nga autoritetet drejtuese përgjegjëse për zbatim pas një periudhe të arsyeshme të zbatimit prej më së shumti dy vjet.

**Neni 219**

1. Vlerësimi i jashtëm bëhet:

1.1. Me nismën e Këshillit drejtues, Senatit ose rektorit

1.2. Me nismën e këshillit të njësive akademike dhe pasi të jetë konsultuar me dekanin;

1.3. Me nismën e Ministrisë dhe pasi të jetë konsultuar me Këshillin drejtues dhe rektorin e Universitetit.

2. Kostoja e vlerësimeve të nisura nga Ministria do të mbulohet nga fondet shtesë të Qeverisë.

**Neni 220**

Njësitë e Universitetit dhe organet e tyre të qeverisjes janë të obliguara të sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe informatat për vlerësim si dhe të bashkëpunojnë.

**Neni 221**

Kryerja e punëve për të gjithë personelin akademik vlerësohet rregullisht në bazë institucionale së paku çdo pesë vjet.

**Neni 222**
**Raporti i punës dhe i përmbushjes së detyrave**

1. Të gjithë kryesuesit dhe udhëheqësit e instituteve apo nënnjësive të tjera organizative të Universitetit do të sigurojnë raportin vjetor të punës dhe përmbushjes së detyrave për dekanët e njësive të tyre akademike.

2. Raporti i punës vjetore përmban:
 2.1. Të dhënat e fundit rreth mësimit në vitin akademik;
 2.2. Të dhënat për punë artistike dhe të dhënat kërkimore të vitit të fundit kalendarik.

**Neni 223**

Çdo dekan i njësisë akademike i siguron rektorit raport të plotë vjetor të punës së njësisë së vet akademike.

**Neni 224**

1. Raporti i punës dhe i përmbushjes së detyrave përmban të dhëna të mjaftueshme lidhur me:
 1.1. Numrin e studentëve (të regjistruar, numrin total, të diplomuarit);
 1.2. Mësimdhënien akademike:
 1.3. programet e studimit dhe lëndët;
 1.4.. Mësimdhënësit, përgjegjësitë e mësimdhënësve dhe ligjëratat e dhëna;
 1.5. provimet dhe punimet seminarike;
 1.6. diplomat dhe disertacionin e doktoratës;
 1.7. rezultatet e vlerësimit të studentëve.
2. Kërkimet shkencore:
 2.1. artikujt e botuar shkencor, monografitë dhe botimet tjera shkencore;
 2.2. raportet e projekteve shkencore;
 2.3. pjesëmarrjet në konferenca dhe punimet e paraqitura;
 2.4. projektet kërkimore të financuara nga burimet publike dhe private;
 2.5. personelin akademik të financuar nga burimet private;

2.6. parametrat e tjerë relevantë të kërkimit shkencor;

3. Krijimtarinë artistike.

4. Një formë standarde dhe e detajizuar nxirret nga Senati për çdo njësi akademike me propozimin e rektorit dhe pasi të jetë konsultuar me dekanin e Këshillit të njësisë përkatëse akademike.

5. Senati përcakton procedurë te vecante për grumbullimin vjetor të raporteve të punës me propozimin e sekretarit të përgjithshëm.

6. Të gjitha të dhënat e kryerjes së detyrave raportohen më së voni deri më 31 mars të vitit vijues.

**Neni 225**

1. Raportet e punës do të përpilohen, mblidhen dhe ruhen në mënyrë të kompjuterizuar dhe standarde.

2. Administrata Qendrore e Universitetit siguron instrumentet e duhura për mbledhjen e të dhënave për mënyrën e punës dhe është përgjegjëse për ruajtjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave.

3. Personi kompetent i çdo njësie akademike vendos për të drejtën e qasjes në të dhënat e njësisë. Sekretari i përgjithshëm si përfaqësues administrativ i rektoratit, dhe si personi më i lartë kompetent në lidhje me këtë ka qasje të pakufizuar në të gjitha të dhënat.

**Neni 226**
**Administrata dhe të dhënat**
**Zyrat administrative**

1. Universiteti do të ofrojë shërbime efikase dhe të dobishme administrative që t'i mundësojë personelit akademik përmbushjen e objektivave dhe përgjegjësitë në fushën e formimit akademik, të kërkimeve shkencore dhe punës artistike, në mënyrën më të mirë të mundshme, siç është paraparë me këtë Statut.

2. Universiteti formon zyrat administrative në nivel të Universitetit dhe për çdo njësi akademike e organizative.

**Neni 227**

1. Administrata Qendrore e Universitetit është përgjegjëse për çështjet profesionale, administrative dhe teknike në lidhje me:

1.1. Arsimin, kërkimet shkencore dhe punën artistike;
1.2. Administrimin e njohjes së studimeve;
1.3. Administrimin e personelit;
1.4. Aspektet ligjore;
1.5. Planin zhvillimor të Universitetit;
1.6. Kontabilitetin dhe financat.
1.7. Mirëmbajtjen dhe dokumentimin e pronës;
1.8. Dosjet;
1.9. Qarkullimin e mallrave;
1.10. Menaxhimin e sistemit të informimit;
1.11. Bazën qendrore të dhënave;

1.12. Aspektet tjera të përgjithshme të administratës së Universitetit.

2. Të gjitha këto detyra koordinohen nga sekretari i përgjithshëm.

**Neni 228**

1. Zyrat administrative të njësive akademike dhe organizative janë përgjegjëse për çështjet profesionale, administrative dhe teknike, struktura e të cilave do të caktohet nga fushëveprimi i vetë njësisë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

2. Të gjitha këto detyra koordinohen nga sekretari i njësisë akademike apo organizative.

**Neni 229**

1. Sekretari i njësisë akademike është shef i zyrës administrative të njësisë akademike. Është përgjegjës që funksionet e caktuara të zyrës administrative të përmbushen në mënyrë efektive dhe efikase. Për punën e vet i përgjigjet dekanit dhe sekretarit të përgjithshëm.

2. Kandidatët për sekretarë duhet t'i përmbushin këto kualifikime:

2.1. Të kenë diplomë universitare me më së paku katër vjet të studimeve ose master;

2.2. Duhet të jenë nga fusha profesionale e drejtësisë;

2.3. Të kenë 3 vjet përvojë pune profesionale;

2.4. Të kenë dije të mjaftueshme në proceset arsimore dhe kërkimore;

2.5. Të kenë aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxhuese;

3. Përzgjedhja e sekretarit të njësisë akademike bëhet sipas rregullave të konkursit publik.

**Neni 230**

1. Këshilli drejtues, me sugjerimin e rektorit, nxjerr rregullore rreth organizimit të brendshëm të shërbimeve të Universitetit.

2. Me sugjerimin e sekretarit të përgjithshëm, rektori nxjerr rregullore rreth sistematizimit të vendeve të punës brenda Administratës Qendrore të Universitetit.

3. Me sugjerimin e sekretarit, dekani apo drejtori nxjerrin rregullore rreth sistematizimit të vendeve të punës brenda zyrës administrative të njësisë akademike apo organizative.

**Neni 231**
**Dosjet**

1. Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për mirëmbajtjen e të dhënave të sakta të zyrave administrative.

2. Përkitazi me këto të dhëna duhet të mbahen dosje të qëndrueshme për:

2.1. Kandidatët që paraqiten për pranim;

2.2. Studentët e regjistruar në të gjitha programet e studimeve dhe të kërkimeve shkencore;

2.3. Të diplomuarit;

2.4. Personelin me kontratë;

2.5. Pronësinë;

2.6. Llogaritë financiare;

2.7. Projektet e kërkimeve, krijuese dhe konsultative;
2.8. Kontratat komerciale;
2.9. Raportet e punës akademike;
2.10. Vlerësimet:
2.10.1. raportet vetanake;
2.10.2. vlerësimet e jashtme dhe të brendshme;

3. Çështje të tjera që kërkohen nga Këshilli drejtues, nga rektori apo Senati.

**Neni 232**

Gjithë personeli dhe studentët e Universitetit duhet të bashkëpunojnë me sekretarin e përgjithshëm të Universitetit, duke i ofruar informatat që kërkohen të mbahen sipas nenit paraprak.

**Neni 233**

1. Të gjitha të dhënat duhet të ruhen në mënyrë të standardizuar elektronike. Këto të dhëna ruhen në bazën qendrore të dhënave në shërbim të çdo njësie akademike dhe organizative dhe mirëmbahen nga Qendra Informative Universitare; siç janë:
1.1. Numri i studentëve dhe libri i studentëve;
1.2. Shifrat buxhetore;
1.3. Të dhënat e infrastrukturës;
1.4. Raportet e punës dhe vlerësimet.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit është përgjegjës për dhënien e të drejtës për qasje në një bazë specifike të dhënave. Rregulloret nxirren nga rektori me propozim të sekretarit të përgjithshëm dhe pasi të jetë konsultuar me dekanët dhe drejtorët e njësive akademike dhe organizative.

**Neni 234**

Të gjitha të dhënat lidhur me personelin mbahen duke respektuar natyrën e tyre private, kurse mund të hapen vetëm për qëllime të caktuara në pajtim me ligjin në fuqi dhe sipas dispozitave të këtij Statuti.

**Neni 235**
**Mediat dhe publikimet e Universitetit**

1. Universiteti funksionon si botues, redaktues i teksteve, i monografive dhe i revistave të tjera shkencore dhe profesionale në përputhje me rregulloren për publikime të nxjerrë nga Senati pasi të jetë konsultuar me Këshillin drejtues.

2. Lidhur me publikimet në Universitet, Senati formon Këshillin botues i cili përbëhet nga dhjetë anëtarë. Prorektori për mësimdhënie është anëtarë i Këshillit botues sipas detyrës zyrtare me të drejtë vote.

3. Anëtarët e Këshillit botues zgjidhen sipas fushave përkatëse të shkencës dhe të artit. Për shkencat që nuk janë përfshirë në Këshillin botues, Senati emëron redaktor profesional.

4. Këshilli botues e zgjedh kryetarin nga radhët e veta. Mandati i anëtarëve të Këshillit botues është tri vjet.
5. Anëtarët e zgjedhur të Këshillit botues janë njëkohësisht edhe redaktor të publikimeve shkencore nga fusha shkencore, profesionale e artistike, të cilës i përkasin.

**Neni 236**

1. Prioritetet vjetore për publikim do të përcaktohen nga Senati në bazë të numrit dhe llojit të kërkesave të bëra nga personeli akademik përmes njësive akademike.
2. Senati i Universitetit nxjerr Rregullore lidhur me kushtet dhe procedurën e botimit, ribotimit dhe përkthimit të publikimeve.

**Neni 237**

1. Buletini i Universitetit botohet rregullisht dhe shërben si gazetë zyrtare e Universitetit.
2. Sekretari i përgjithshëm i Universitetit është redaktor përgjegjës i Buletinit të Universitetit.
3. Njësia akademike nxjerre revisten profesionale shkencore-artistike

**Neni 238**

1. Gazeta e studentëve të Universitetit botohet rregullisht.
2. Rektori do të emërojë redaktorin përgjegjës për gazetën e studentëve pasi të jetë konsultuar me redaksinë e gazetës së studentëve.
3. Redaksia formohet nga 6 anëtarë të cilët zgjidhen nga parlamenti i studentëve.
4. Studentët angazhohen si gazetarë me honorar në gazetën e studentëve deri në 6 muaj. Hollësitë rreth detyrave të punës dhe procedurave të punësimit përshkruhen me rregulloren e nxjerrë nga redaksia.

**Neni 239**
**Dispozitat kalimtare**

1. Ky Statut miratohet nga Senati i Universitetit në propozim të Këshillit drejtues.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, procedurat e zgjedhjes së zyrtarëve dhe organeve qeverisëse të Universitetit janë të detyrueshme.
3. Zgjedhjet do të bëhen sipas rendit që siguron procedura të vazhdueshme në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.
4. Konkursi për rektor shpallet nga Këshilli drejtues brenda kohës së caktuar.

**Neni 240**

Të gjitha programet e studimeve, që janë duke u zbatuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti konsiderohen të aprovuara në pajtim me vendimet mbi akreditimin e tyre të nxjerra nga AKA dhe Ministria.

**Neni 241**

1. Të gjitha kontratat e personelit akademik do të vazhdojnë me të njëjtat kushte deri me datën e caktuar në kontratë. Vazhdimi i kontratave bëhet në pajtim me këtë Statut.
2. Personeli qe bartë thirrjen akademike "Asistent i ri" do të vazhdojç ta mbajë këtë thirrje sipas vendimit dhe afatit të caktuar në vendimin më të cilin është emëruar-zgjedhë në këtë thirrje
3. Të gjitha aktet e emërimit dhe kontratat e personelit joakademik vazhdojnë me të njëjtat kushte në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**Neni 242**

Më hyrjen në fuqi të këtij Statuti, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë, nuk është më njësi akademike në kuadër të UP – së. Të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve dhe të punësuarve sikurse edhe objektet e kësaj njësie akademike barten në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" i themeluar si universitet publik.

**Neni 243**
**Dispozitat përfundimtare**

1. Universiteti i Prishtinës dhe njësitë akademike dhe organizative do ti harmonizojnë aktet dhe rregulloret ekzistuese në përputhje me këtë Statut pasi që ky Statut të hyjë në fuqi.
2. Deri në nxjerrjen e akteve sikurse në pikën një të këtij neni, do të aplikohen aktet në fuqi përveç në rastet kur ato janë në kundërshtim me këtë Statut dhe Ligjin për Arsimin e Lartë.

**Neni 244**

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejnë dispozitat e statutit të Universitetit të Prishtinës të datës 5 korrik 2004.

**Neni 245**

Ky Statut hyn në fuqi diten e miratimit ne Kuvend.

Jakup Krasniqi

Kryetar i Kuvendit të Republikës
së Kosovës